



PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR

Energji dhe Klimë

PKVEK – JUNIK

2025 – 2028



Financuar nga
Bashkimi Evropian

PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT PËR

Energji dhe Klimë

PKVEK – JUNIK

2025 – 2028

Projekti EFFORT - “Përmirësimi i Objekteve për një të Ardhme me një Trajektore Optimale të Burimeve dhe Efiçencës së Energjisë” ka për qëllim përmirësimin e efiçencës së energjisë në ndërtesat publike të Bashkisë Mirditë dhe Komunës Junik. Përmes implementimit të teknologjive inovative dhe masave për reduktimin e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazeve të efektit serrë, projekti do të ndihmojë në përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ndërtesave dhe do të kontribuojë në uljen e ndikimeve negative mjedisore. Gjithashtu, projekti fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Mirditë dhe Komunës Junik, Kosovë, si dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira. Pjesë e rëndësishme është edhe rritja e ndërgjegjësimit publik për përfitimet e efiçencës së energjisë dhe zbatimi i masave për edukimin dhe përfshirjen e komunitetit në këtë proces.



Deklarim

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit EFFORT - “Përmirësimi i Objekteve për një të Ardhme me një Trajektore Optimale të Burimeve dhe Eficiencës së Energjisë”, i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit IPA Cross-Border Shqipëri-Kosovë. Pikëpamjet dhe konkluzionet e përfshira në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian, Programit IPA Cross-Border Shqipëri-Kosovë apo institucioneve të tjera partnere. Dokumenti është hartuar nga ekspertët e projektit bazuar në informacionin dhe njohuritë më të mira të disponueshme.

Ky material mund të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në projekt dhe nuk mund të shpërndahet ose modifikohet pa miratimin paraprak të palëve përkatëse. Për çdo informacion shtesë ose kërkesa të tjera, ju lutemi të kontaktoni autoritetet përkatëse të projektit.



MIRËNJOHJE

Plani Komunal i Veprimit për Energjinë dhe Klimën (PKVEK) për Komunën Junik është hartuar falë bashkëpunimit të ngushtë midis Komunës Junik dhe projektit EFFORT - “Përmirësimi i Objekteve për një të Ardhme me një Trajektore Optimale të Burimeve dhe Eficiencës së Energjisë”.

Një falënderim i veçantë i drejtohet Kryetarit të Komunës Junik, z. Ruzhdi Shehu, për mbështetjen institucionale dhe angazhimin e vazhdueshëm gjatë gjithë procesit. Nga ana e Komunës Junik, procesi u ndoq dhe u koordinua nga z. Demokrat Ganiqaj, koordinator i projektit dhe Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspeksion (DSHPI), në bashkëpunim me z. Arian Xhuli – Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis (DUKM), znj. Klodiana Pepshi – Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DAKRS), z. Arten Hamza – Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (DBF), z. Idriz Gacaferi, z. Baki Krasniqi dhe z. Turim Ganiqaj – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion (DSHPI), si dhe z. Fatos Shala – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS), znj. Vjollca Qestaj – Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe znj. Leonora Shehu – Drejtoria për Administratë Publike. Kontributi i këtij grupi pune në sigurimin e të dhënave bazë ka qenë thelbësor për hartimin e PKVEK, përcaktimin e objektivave dhe formulimin e strategjisë së zbatimit të masave, duke siguruar që masat e propozuara të jenë realiste dhe të zbatueshme.

Një falënderim i veçantë shkon për ekspertët e CoPlan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, të cilët realizuan një analizë të detajuar të të dhënave, duke përcaktuar situatën aktuale të energjisë dhe klimës, identifikimin e potencialeve të kursimit dhe vlerësimin e reduktimit të gazeve të efektit serrë.

Përkushtimi dhe profesionalizmi i ekspertëve të CoPlan, përfshirë z. Elvis Ndreka, znj. Rudina Çopa, z. Imeldi Sokoli, znj. Greta Shehu, znj. Enkela Poro, znj. Fiona Imami, znj. Kejt Dhrami, znj. Ogerta Gjikhuri, znj. Erinda Dheskali dhe znj. Klesta Galanxhi, kanë qenë kyç në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik.

Ky bashkëpunim i frytshëm shërben si një shembull i mirë i përpjekjeve të përbashkëta për të arritur objektivat e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së energjisë në nivel vendor.

Falënderime të singerta për të gjithë të përfshirët në këtë proces!

Përmbajtja

Kapitujt

1. Hyrje	8
1.1 Objektivi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë	10
1.2 Kuadri Ligjor dhe Politik	11
1.3 Procesi Përgatitor i PKVEK	13
1.4. Zhvillimi i PKVEK	13
1.5 Përfitimet e Pritshme nga Zbatimi i Planit	14
2. Metodologjia e Planit dhe Procesi i Grumbullimit të të Dhënave	15
3. Gjendja Ekzistuese dhe Karakteristikat e Përgjithshme të Territorit	16
3.1 Pozicionimi Gjeografik, Relievi dhe Veçoritë Fizike të Territorit	16
3.2 Zhvillimi i Territorit dhe i Vendbanimeve	17
3.3 Tendencat e Popullsisë	20
3.4 Klima dhe Ndikimi në Prodhimin e Energjisë nga Panelet Diellore	21
3.5 Shërbimet Publike dhe Shpërndarja e Tyre	22
3.6 Shërbimet Sociale dhe Standardi i Jetesës në Komunën e Junikut	26
3.7 Ekonomia Lokale, Ndërmarrjet Ekonomike dhe Buxheti Komunal	28
3.7.1 Bujqësia dhe aktivitetet bujqësore në komunën e Junikut	28
3.7.2 Resurset Natyrore dhe Potenciali për Zhvillimin e Turizmit	31
3.8 Mjedisi, Burimet Natyrore, Burimet Ujore dhe Zonat e Mbrojtura	32
3.9 Analiza e kapaciteteve institucionale	34
4. Përmbledhje e të Dhënave të Grumbulluara dhe Treguesit në Nivel Komune	35
5. Projekte dhe Shembuj të Zbatimit të Parimeve të Efiçencës së Energjisë në Territor	39
6. Prodhimi dhe Rrjeti i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në NJQV	40
6.1 Struktura e Rrjetit Energjetik dhe Infrastruktura e Shpërndarjes së Energjisë	40
7. Vlerësimi i Konsumit të Energjisë	42
7.1 Analiza Energjitike e Shërbimeve Publike	40
7.1.1 Ndërtesat Publike	43
7.1.2 Objektet Rezidenciale dhe Tregtare	47
7.1.3 Transporti Publik dhe Mjetet e Transportit në Pronësi të Komunës	48
7.1.4 Shërbimi i Mbetjeve dhe Transporti i Tyre	49
7.1.5 Shërbimi i Ndricimit Publik	50
7.1.5 Analiza e Varferisë Energjitike	52
8. Analiza e Emetimeve të Gazeve të Efektit Serrë	53
9. Vizioni i Planit	55
10. Projektet dhe Masat e Ndërmarra/ Plani i Veprimit	55
10.1 Projekt-fishat sipas programeve	56
10.2 Plani i veprimit të Projekteve	60
11. Financimi	62
12. Monitorimi i Projekteve dhe Masave	63
13. Referencat	65

Lista e Figurave

Figura 1. Harta fizike e territorit dhe relievi i Komunës Junik	16
Figura 2. Harta e përdorimit të tokës Komuna Junik	17
Figura 3. Harta e ndërtimeve në Komunën e Junikut	19
Figura 4. Harta e dendësisë së popullsisë në Komunën e Junikut	20
Figura 5. Harta e Infrastrukturës së aksesit në Komunën e Junikut	24
Figura 6. Organigrama e Komunës Junik	34
Figura 7. Harta e objekteve publike sipas cilësisë së ndërtesës në Komunën Junik	45
Figura 8. Harta e itinerarit të transportit të mbetjeve Komuna Junik	50

Figura 9. Harta e akseve rrugore të ndriçuara	51
---	----

Lista e Tabelave

Tabela 1. Popullsia e Junikut gjatë viteve (Burimi: ESK)	19
Tabela 2. Popullsia sipas moshës dhe gjinisë	19
Tabela 3. Rrjeti rrugor	22
Tabela 4. Lidhjet e transportit ndërrurban	24
Tabela 5. Numri nivelet e arsimit në procesin edukativo-arsimor 2024-2025	26
Tabela 6. Numri i fermave sipas madhësisë	28
Tabela 7. Kategoritë e pyjeve në Komunën Junik	28
Tabela 8. Konsumi i energjisë sipas llojit	35
Tabela 9. Konsumi i energjisë në vitin 2023 për ndërtesat publike	35
Tabela 10. Konsumi i energjisë në vitin 2023 për ndërtesat e banimit	36
Tabela 11. Konsumi i energjisë në vitin 2023 për automjetet në disponim të Komunës Junik	36
Tabela 12. Specifikimet e flotës së automjeteve Komuna Junik	36
Tabela 13. Specifikimet e rrjetit të ndriçimit publik	37
Tabela 14. Projektet të cilat lidhen e efijencën e energjisë në Komunën e Junikut	38
Tabela 15. Nënstacionet elektrike të furnizimit me energji në Komunën e Junikut	39
Tabela 16. Llojet e konsumit të energjisë së konsumuar, sasia dhe vlera energjitike	41
Tabela 17. Konsumi i energjisë elektrike dhe termike	41
Tabela 18. Konsumi i energjisë total i institucioneve të administrates	42
Tabela 19. Konsumi i energjisë në ndërtesat e arsimit	44
Tabela 20. Konsumi i energjisë në ndërtesat e shëndetsisë	45
Tabela 21. Konsumi energjitik në sektorin privat sipas tremujorëve në Komunën Junik	46
Tabela 22. Flota e automjeteve dhe konsumi energjitik i tyre	47
Tabela 23. Specifikimet mbi transportin e mbetjeve	47
Tabela 24. Konsumi i CO2 në raport me konsumin e energjisë	52
Tabela 25. Reduktimi i energjisë dhe i Co2 me implementimin e masave të PKVEK Junik	53

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Sasia e Prodhuar e CO2 në Republikën e Kosovës	8
Grafiku 2. Llojet e veprimtarive në Junik	32

1. HYRJE


Ndryshimet klimatike dhe tranzicioni energjetik përbëjnë sfida thelbësore për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Republikën e Kosovës. Rritja e temperaturave, ndotja e ajrit, degradimi i resurseve natyrore dhe mungesa e burimeve të qëndrueshme të energjisë kërkojnë veprime të shpejta dhe të mirëkoordinuara në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në këtë kontekst, zhvillimi i politikave të integruara për energjinë dhe klimën është bërë një prioritet i domosdoshëm, që lidhet ngushtë me përpjekjet për integrimin evropian, mirëqenien e qytetarëve dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Sektori energjetik në Kosovë është i karakterizuar nga një varësi e madhe ndaj thëngjillit, si burimi kryesor i prodhimit të

energjisë elektrike. Sipas Eurostat, rreth 95% e energjisë elektrike prodhohet nga termocentralet me thëngjill, ndërsa vetëm 2.7% nga hidrocentralet dhe 2.3% nga burimet e ripërtëritshme si era dhe energjia diellore. Kjo strukturë e prodhimit e bën vendin të ekspozuar ndaj krizave të ndotjes, si dhe ndaj sfidave të qëndrueshmërisë energjetike.

Ndikimi mjedisor i kësaj varësie është i konsiderueshëm. Bashkimi Evropian klasifikon thëngjillin si një burim me intensitet të lartë ndotjeje, ndërsa të dhënat e publikuara nga Global Carbon Atlas (2024) tregojnë se Republika e Kosovës gjeneron rreth 8 milionë tonë CO₂ në vit, duke u renditur në vendin e 115 në botë për sasinë e emetimeve.

Grafiku 1. Sasia e Prodhuar e CO₂ në Republikën e Kosovës



Burimi: Global Carbon Atlas 2024

Në kuadër të përpjekjeve për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare dhe për të adresuar sfidat mjedisore dhe energjetike, Kosova ka ndërmarrë një sërë iniciativash për të zvogëluar varësinë nga burimet fosile dhe për të kaluar në një model energjetik

më të qëndrueshëm. Ndonëse ende nuk ka një detyrim të plotë ligjor për të reduktuar emetimet e gazrave serrë, vendi ka hartuar një sërë dokumentesh strategjike, përfshirë Udhërrëfyesin për Dekarbonizimin, i cili është miratuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit

të Energjisë në vitin 2021. Ky dokument parashikon futjen gradual të çmimit të karbonit deri në vitin 2025 si një mekanizëm për të stimuluar kalimin nga burimet fosile në ato të rinovueshme dhe për të reduktuar emetimet e gazrave serrë. Ky zhvillim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin energjetik, duke e bërë më pak të favorshëm prodhimin e energjisë nga thëngjilli dhe duke nxitur përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Në kuadër të angazhimeve të saj për të arritur objektivat e Marrëveshjes së Parisit dhe të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, Kosova ka hartuar Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (PKEK), i cili është një dokument strategjik për zhvillimin e sektorit energjetik dhe reduktimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Ky plan përfshin pesë shtylla kryesore: dekarbonizimi, efikasiteti energjetik, siguria e furnizimit me energji, zhvillimi i tregut të energjisë dhe kërkimi e inovacioni. Objektivat e PKEK përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në energjinë e prodhuar, uljen e konsumit të energjisë përmes masave të efikasitetit dhe zhvillimin e infrastrukturës për energji të pastër. Ky plan është pjesë e angazhimeve të Kosovës për të kontribuar në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike dhe për të përmbushur standardet e BE-së në fushën e energjisë dhe klimës.

Në përputhje me objektivat e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, Komuna e Junikut ka hartuar Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK-Junik) për periudhën 2025–2028, i cili është një dokument strategjik që orienton politikat dhe masat lokale për zhvillimin e një sistemi energjetik të qëndrueshëm. Ky plan është pjesë e angazhimeve për të zbatuar politikat kombëtare dhe për të kontribuar në realizimin e objektivave të PKEK. PKVEK-Junik përqendrohet në rritjen e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Një nga objektivat kryesore të PKVEK-Junik është rritja e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme, si energjia diellore, si dhe përmirësimi i efikasitetit energjetik në sektorët publik dhe privat. Po ashtu, planifikohen masa për zvogëlimin e konsumit të energjisë dhe për adaptimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, si p.sh. përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e ujërave dhe gjelbërimi i hapësirave publike. PKVEK-Junik do të ndihmojë në orientimin e burimeve të financimit për projekte të energjisë së pastër dhe do të sigurojë një kuadër të qartë për monitorimin e realizimit të masave të propozuara, në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Ky plan, i integruar me objektivat dhe strategjitë kombëtare, është një hap i rëndësishëm për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Junikut, duke kontribuar në përpjekjet kombëtare dhe rajonale për një të ardhme më të pastër dhe më të qëndrueshme.

Hartimi i PKVEK - Junik është iniciativë e projektit “EFFORT - Përmirësimi i objekteve për një të ardhme me një trajektore optimale të burimeve dhe efikasitetit të energjisë”, i financuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet Instrumentit të Asistencës së para-Aderimit në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë 2014-2020 (IPA II). Projekti zbatohet nga partneriteti ndërmjet Bashkisë Mirditë në Shqipëri, Komunës së Junikut në Kosovë dhe Organizatës CoPlan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në Shqipëri.

Projekti, me një kohëzgjatje 36-mujore, ka si objektiva kryesore përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave publike në dy njësitë e qeverisjes vendore dhe zvogëlimin e ndjeshëm të konsumit të energjisë, duke instaluar pajisje inovative dhe duke promovuar më tej praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të ndërtesave. Projekti synon gjithashtu të lehtësojë shkëmbimin e njohurive dhe bashkëpunimin, duke promovuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në lidhje me efikasitetin e energjisë.

Në kuadër të projektit do të angazhohen aktorë të ndryshëm në nivel lokal dhe kombëtar, për të siguruar zbatimin e suksesshëm të masave dhe strategjive për energjinë e rinovueshme, eficiencën e energjisë dhe klimën. Ky proces do të realizohet në përputhje me politikat përkatëse në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Përmes këtij angazhimi, projekti do të sigurojë një koordinim të ngushtë me politikat dhe strategjitë ekzistuese të energjisë dhe klimës, duke kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar për rajonin në tërësi.

Në këtë kuadër, do të hartohen Plani Vendor i Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Bashkinë Mirditë dhe Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë për Komunën Junik, si një hap i rëndësishëm drejt institucionalizimit të objektivave të projektit. Krahas hartimit të planeve, projekti parashikon edhe organizimin e trajnimeve përkatëse, me synimin për të forcuar kapacitetet në nivel lokal, në fushën e energjisë së rinovueshme dhe përmirësimit të eficiencës së energjisë në sektorë të ndryshëm.

1.1 Objektivi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë

Komuna e Junikut, në përputhje me Ligjin për Eficiencë të Energjisë nr. 06/L-079, ka përgjegjësi për hartimin dhe përditësimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE), i cili duhet të rishikohet dhe miratohet çdo tre vjet. Ky plan përfaqëson angazhimin lokal për të përmirësuar përdorimin e energjisë dhe për të kontribuar në objektivat e qëndrueshmërisë energjetike në nivel kombëtar.

Ndërkohë, në nivel qendror, Kosova po përgatit Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK), i cili synon të zëvendësojë dokumentet e veçanta strategjike për eficiencë të energjisë dhe burime të ripërtëritshme, duke i integruar në një qasje të përbashkët për arritjen e objektivave klimatike dhe energjetike për vitin 2030 dhe përtej.

Duke qenë se PKEK do të shërbejë si dokumenti udhëzues për zhvillimin e politikave të qëndrueshme në nivel kombëtar, edhe komunat pritet të harmonizojnë veprimet e tyre për energji dhe klimë me këtë strategji. Kjo përfshin zhvillimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK), si një mjet i rëndësishëm planifikimi që shërben për të strukturuar veprimet lokale për dekarbonizimin dhe qëndrueshmërinë energjetike.

Hartimi i PKVEK nga Komuna e Junikut mbështetet gjithashtu në:

- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, i cili u jep komunave kompetenca për të ndërmarrë veprime në fushën e energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Ligjin për Ndryshimet Klimatike (janar 2024), i cili vendos bazën për zhvillimin e politikave dhe planeve për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Traktatin e Komunitetit të Energjisë, ku Kosova si palë kontraktuese ka marrë përsipër zbatimin e objektivave të BE-së për energji dhe klimë, përfshirë decentralizimin e planifikimit dhe veprimit.

PKVEK do të përfshijë vlerësimin e konsumit aktual të energjisë dhe potencialit për burime të ripërtëritshme, një inventar bazë të emetimeve të CO₂, si dhe masa të përcaktuara për përmirësimin e eficiencës energjetike dhe reduktimin e emetimeve. Plani do të përmbajë objektiva të matshëm, afate kohore për realizimin e tyre, ndarjen e përgjegjësisë dhe parashikimin e kostove dhe burimeve të financimit.

Në thelb, objektivi i PKVEK është të orientojë zhvillimin e komunës drejt një modeli të qëndrueshëm energjetik, në përputhje me angazhimet që Kosova ka marrë në kuadër të Konventës së Kryetarëve të Komunave, ku parashikohet reduktimi i emetimeve të CO₂ me të paktën 40% deri në vitin 2030.

Zbatimi i këtij plani pritet të sjellë përfitime të shumta për Komunën e Junikut, përfshirë zhvillimin ekonomik lokal, përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve energjetike publike, ngritjen e cilësisë së ndërtesave, rritjen e ndërgjegjësimit qytetar, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetin.

Përmes PKVEK, Komuna e Junikut synon të jetë një shembull i mirë për qasjen lokale në çështjet e energjisë dhe klimës, duke kontribuar në mënyrë aktive në përpjekjet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë banorët.

1.2 Kuadri Ligjor dhe Politik

Baza ligjore mbi klimën dhe energjinë në nivel kombëtar mbështete në procesin e përafrimit ligjor me udhëzimet e BE-së në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane e cila shihet si politika kuadër kryesore në uljen e efekteve të ndryshimve klimatike në Evropë.

Me qëllim të mbështetjes së vendeve anëtare për të kaluar nga shfrytëzimi i burimeve energjetike fosile drejt formave të pastra të energjisë, si dhe me qëllim të realizimit të zotimeve të dhëna në kuadër të marrëveshjes së Parisit, të aprovuar në 2015, BE në vitin 2019 ka rishikuar kornizën e vet ligjore lidhur me energjinë dhe klimën. Korniza e re ligjore e BE-së ofron përparësi të shumta për konsumatorët, mjedisin dhe ekonominë e vendeve përkatëse. Në këtë kuadër, direktivat kryesore në kuadër të kornizës së rishikuar ligjore të BE-së janë si vijon:

- Direktiva lidhur me performancën energjetike të ndërtesave (EU 2018/844);
- Direktiva për burimet e ripërtëritshme të energjisë (2018/2001/EU);
- Direktiva për eficiencën e energjisë (EU 2018/2002);
- Rregullorja për Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimit për Klimën (EU 2018/1999);

- Rregullorja për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (EU 2019/943).

Gjatë dekadës së fundit, disa dokumente ligjore janë miratuar dhe ndryshuar, duke siguruar që legjislacioni energjetik të jetë plotësisht në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE).

Hapat e parë drejt krijimit të politikave energjetike të Kosovës u ndërmorën në vitin 2004, me miratimin e tre ligjeve bazë për sektorin e energjisë: Ligji për Energjinë 05 / L-081, Ligji për Energjinë Elektrike 05 / L-085, dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë 05 / L-084. Një përparim i rëndësishëm drejt krijimit të një kornize të qëndrueshme ligjore u arrit pas nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore në vitin 2005.

Korniza ligjore për energjinë në Republikën e Kosovës përfshin dokumente strategjike, ligje, udhëzime dhe rregullore administrative. Brenda këtyre dokumenteve përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave në sektorin e energjisë, disa prej të cilave do të trajtohen shkurtimisht në vijim. Ligji për Energjinë (LIGJI Nr. 05/L-081) - Neni 9- Roli i qeverisjes lokale thotë se organet e qeverisjes lokale, duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore, të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe balanceve të energjisë.

Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 09/2017, datë 6 shtator 2017, "Për Zyrat Komunale të Energjisë" përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të energjisë për të adresuar çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave energjetike në nivel lokal. Disa prej përgjegjësive kryesore të listuara në këtë Udhëzim Administrativ për Zyrat Komunale për Energji janë si vijon:

- Krijimi i një baze të dhënash dhe mbajtja e sistemit të informacionit për grumbullimin e rregullt të të dhënave për konsumin e energjisë në baza periodike, shpenzimet e

energjisë dhe të dhëna të tjera relevante duke përfshirë mbajtjen e një regjistri i cili mundëson përzgjedhjen e indikatorëve potencial të efijencës së energjisë për ndërtesat komunale të cilat janë konsumatorë të energjisë.

- Raportimi lidhur me zbatimin e PKVEK dhe në rastet kur është e nevojshme dhënia e propozimeve lidhur me korrigjimet që duhet të bëhen për implementimin e plotë të programit.
- Zhvillimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me planifikimet në sektorin e energjisë, bazuar në Strategjinë e Energjisë, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave.
- Sigurimi i të dhënave të nevojshme për Ministrinë përkatëse në funksion të rishikimit dhe përgatitjes së Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për tre (3) vjet në pajtim me Ligjin për Energjinë,
- Monitorimi i vazhdueshëm i progresit lidhur me zbatimin e PKVEK në nivelin komunal dhe raportimi përkatës pranë Ministrisë përgjegjëse.

Baza ligjore e Republikës së Kosovës e cila rregullon fushën e energjisë përbëhet nga ligjet, udhëzimet administrative (UA) dhe rregulloret specifike. Në këtë kontekst, aktet kryesore ligjore janë si vijon:

- Ligji për Energjinë 05 / L-081;
- Ligji për Energjinë Elektrike 05 / L-085;
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë 05 / L-084;
- Ligji për Efijencën e Energjisë 06 / L-079;
- Ligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa 05/L-101;
- Ligji për Ngrohje Qendrore 03 / L-116;
- Ligji për Ndërtimet 04 / L-110;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë;
- Udhëzimi administrativ Nr. 06/2017 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme;
- Udhëzimi administrativ Nr. 03/2019 për përmbajtjen e energjisë së lëndëve djegëse

të përcaktuara për përdorim fundor;

- Udhëzimi administrativ Nr. 03/2020 lidhur me kërkesat për efijencën e energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror;
- Udhëzimi administrativ Nr. 10/2020 për metodat dhe parimet e përbashkëta për llogaritjen e ndikimit të efijencës së energjisë;
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2020 për potencialin e efijencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje;
- Udhëzimi administrativ Nr. 06 / 2020 për llogaritjen e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi;
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2020 për kushtet e përgjithshme për analizën e kosto përfitimit në lidhje me masat për promovimin e efijencës së energjisë në ngrohje dhe ftohje;
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2020 për metodologjinë lidhur me përcaktimin e efijencës nga procesi i bashkëprodhimit;
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2021 për kornizën e përgjithshme të raportimit për efijencën e energjisë;
- Udhëzimi administrativ Nr. 06/2021 për shërbimet e energjisë (ESCO);
- Rregullorja e MMPH Nr. 01/2018 për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe sistemeve për kondicionim të ajrit;
- Rregullorja e MMPH Nr. 02/2018 për metodologjinë kombëtare për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të ndërtesave;
- Rregullorja e MMPH Nr. 03/2018 për procedurën e çertifikimit të performancës energjetike në ndërtesa;
- Rregullorja e MMPH Nr. 04/2018 për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave;
- Rregullorja për kushtet e përgjithshme të operimit të Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), 2019;
- Rregullorja Nr. 01/2020 për kriteret minimale për auditoret e energjisë përfshirë ato të kryera si pjesë e sistemeve të menaxhimit të energjisë;
- Rregullorja Nr. 02/2020 për kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin

e faturimit bazuar në konsumin aktual;

- Rregullorja Nr. 05/2020 për sistemet e ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për auditimin energjetik.

1.3 Procesi Përgatitor i PKVEK

PKVEK është një dokument gjithëpërfshirës afatmesëm, i cili hartohet me qëllim të ndryshimit të kushteve dhe praktikave në nivel komunal në fushën e energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Si të tilla, PKVEK janë dokumente komplekse, për zbatimin e të cilave kërkohet përkushtim i strukturave më të larta komunale, gjithëpërfshirje dhe konsistencë, e cila duhet të përcillet me masa përkatëse në burimet njerëzore, rregullimin institucional dhe komunikimin me qytetarët. Disa prej veprimeve konkrete, të cilat janë të nevojshme të ndërmerren me qëllim të krijimit të parakushteve të nevojshme për hartimin dhe zbatimin me sukses të PKVEK, janë si vijon:

- Integrimi i objektivave dhe masave të PKVEK në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të Komunës;
- Emërimi i stafit profesional për planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kursimit të energjisë, aplikimin e masave të efikasitetit të energjisë, aplikimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme dhe lëndëve djegëse ekologjike të pranueshme;
- Vlerësimi dhe planifikimi i mjeteve të nevojshme financiare për zbatimin e PKVEK;
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave të kursimit të energjisë dhe kursimeve financiare, si dhe monitorimi i reduktimit të gazrave serrë;
- Mbështetja e zbatimit të masave të parashikuara në të gjithë periudhën e parashikuar të zbatimit të PKVEK, deri në vitin 2026;
- Monitorimi dhe raportimi mbi dinamikën e zbatimit të PKVEK deri në vitin 2026;
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve në lidhje me shkallën e zbatimit të PKVEK;
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë aktorëve kryesorë dhe qytetarëve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të PKVEK.

1.4. Zhvillimi i PKVEK

Procesi i hartimit të PKVEK për Komunën e Junikut është ndërtuar mbi analiza të detajuara të konsumit të energjisë, identifikimin e sektorëve prioritarë dhe përzgjedhjen e masave konkrete për zbatim. Si vit referencë për këtë proces është përdorur viti 2023, bazuar në të dhëna të sigurt të siguruar nga burimet komunale dhe nga plane ekzistuese të mëparshme. Këto të dhëna janë përdorur për të ndërtuar një bazë reale dhe gjithëpërfshirëse për planifikimin e veprimeve në funksion të një plani të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm në nivel komunal.

Aktivitetet kyçe të procesit të zhvillimit të PKVEK përfshijnë:

- Përcaktimi i vitit bazë për zbatimin e planit;
- Zhvillimi i analizës së gjendjes ekzistuese dhe përgatitja e dokumentacionit mbështetës për investime;
- Klasifikimi i konsumatorëve të energjisë në sektorë të ndryshëm (ndërtesa, transport, ndriçim publik);
- Analizimi i konsumit të energjisë për secilin sektor përkatës;
- Identifikimi i sektorëve me prioritet për ndërhyrje bazuar në analizat e konsumit;
- Përgatitja paralelisht e auditimeve të energjisë për ndërtesat ku planifikohet të realizohen investime;
- Zhvillimi i inventarit bazë të shkarkimeve të CO₂;
- Përcaktimi i masave për reduktimin e shkarkimeve të CO₂ deri në vitin 2026;
- Përcaktimi i afateve kohore dhe programit të zbatimit të planit;
- Identifikimi i mekanizmave të financimit për zbatimin e masave;
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore brenda Njësive të Qeverisjes Vendore për zbatimin e suksesshëm të planit.

Të dhënat e përdorura për këtë proces janë siguruar nga zyrtarët lokalë, nga dokumentet ekzistuese dhe nga burime të tjera të besueshme, duke përfshirë të dhënat e konsumit për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Për shkak të mungesës së investimeve të mëdha gjatë këtyre viteve, është vlerësuar që konsumi i energjisë në sektorët përkatës ka qenë i qëndrueshëm dhe i krahasueshëm.

Sa i përket konsumatorëve të energjisë në Komunën e Junikut, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, të njëjtit janë të kategorizuar në tre sektorë:

- Ndërtesat;
- Transporti;
- Ndriçimi publik.

Sektori i ndërtesave është ndarë më tej në tri nënsektorë: ndërtesat në pronësi të komunës, ndërtesat e sektorit privat (zyra biznesesh, banka, shkolla dhe shërbime private) dhe ndërtesat e banimit. Për të analizuar konsumin e energjisë në këto ndërtesa janë marrë të dhëna për numrin e ndërtesave dhe karakteristikat e tyre, konsumin e energjisë elektrike dhe konsumin e energjisë për ngrohje, përfshirë burimet si druri, peleti dhe derivatet e naftës.

Për sektorin e transportit janë analizuar automjetet në pronësi të komunës dhe institucioneve publike, duke përfshirë të dhënat për numrin e mjeteve, llojin dhe sasinë e karburantit të konsumuar. Ndërsa për sektorin e ndriçimit publik është bërë analiza e strukturës së rrjetit ndriçues, përfshirë numrin dhe llojin e llambave, gjatësinë e rrugëve të mbuluara dhe konsumin e energjisë elektrike për ndriçim. Edhe pse Republika e Kosovës nuk e ka ratifikuar ende Protokollin e Kiotos, përcaktimi i inventarit të shkarkimeve referente të CO₂ për Komunën e Junikut do të bëhet në përputhje me Protokollin e Panelit Ndërqeveritar mbi Ndryshimin e Klimës (PNNK) duke përdorur faktorët e shkarkimit zyrtarë të Republikës së Kosovës. PNNK është organi zbatues i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) dhe Organizatës Meteorologjike Botërore (WMO) për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC).

Për secilën masë të propozuar në plan do të analizohen kursimet e mundshme të energjisë deri në vitin 2026, afatet e zbatimit, mundësitë për financim, kostot përkatëse dhe ndikimi i mundshëm në reduktimin e emetimeve të CO₂.

Një komponent thelbësor i masave të propozuara nga PKVEK është përputhshmëria me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjitha masat dhe aktivitetet e përfshira janë në harmoni me legjislacionin e Komunës së Junikut, të Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian.

1.5 Përfitimet e Pritshme nga Zbatimi i Planit

Zbatimi i PKVEK pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme për Komunën e Junikut, duke përfshirë përmirësime financiare, mjedisore dhe operacionale. Përfitimet e pritshme nga zbatimi i PKVEK përfshijnë:

- Përmirësimi i efijencës së energjisë në proceset e prodhimit dhe zbatimi i teknologjive të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, duke zvogëluar ndikimin negativ në mjedis dhe rritur produktivitetin. Ky proces do të rrisë gjithashtu prodhimin e energjisë së rinovueshme në bilancin total të energjisë në territorin komunal.
- Planifikimi më i mirë dhe optimizimi i shërbimeve të energjisë, furnizimit me ujë, grumbullimit dhe riciklmit të mbeturinave, si dhe ndriçimit publik të rrugëve dhe shesheve.
- Kursimi i energjisë dhe rritja e investimeve në sektorin e energjisë përmes tërheqjes së fondeve nga institucione vendore dhe ndërkombëtare, si dhe mundësive për partneritete publike-private.
- Rritja e mundësive për investime kapitale dhe sociale në nivelin komunal, duke zvogëluar koston e energjisë përmes zbatimit të masave të kursimit të energjisë.

- Përbushja e detyrimeve kombëtare të ligjeve dhe rregulloreve të energjisë, që do të kontribuojnë në zhvillimin e

qëndrueshëm të territorit dhe përputhjen me normat ndërkombëtare.

2. METODOLOGJIA E PLANIT DHE PROCESI I GRUMBULLIMIT TË TË DHËNAVE

Plani Komunal i Veprimit për Energji dhe Klimë në Komunën e Junikut zhvillohet nëpërmjet një procesi të strukturuar dhe gjithëpërfshirës, ku si partner kryesor është Komuna Junik, e cila udhëheq procesin e mbështetur nga konsulentët. Ky proces zhvillohet në monitorim nga Agjencia e Kosovës për efikasitet të Energjisë po ashtu në koordinim me institucione të tjera kombëtare të sektorit të energjisë siç janë Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE), Kompania Kosovare e Distributimit të Energjisë Elektrike në Kosovë sh.a (KEDS) si dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Ky proces nis me një sërë takimesh me administratën e komunës, për mbledhjen e të dhënave mbi situatën aktuale të konsumit të energjisë në sektorët kryesorë, si banesat, industria, transporti dhe shërbimet publike. Për të ndihmuar në ndërtimin e planit, grupi i punës ka mbledhur të gjitha të dhënat që disponon komuna, duke përfshirë informacion mbi konsumimin e energjisë elektrike, sasine e karburantit që përdoret për transport, furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, bujqësinë, ndriçimin publik, grumbullimin e mbetjeve dhe numrin e automjeteve të pasagjerëve.

Hapi tjetër është mbledhja e të dhënave nga drejtoritë e tjera dhe koordinimi i procesit të Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë me drejtoritë përkatëse. Gjatë këtij hapi, është diskutuar në shumicën e rasteve për përfshirjen e tyre në dëgjesa dhe konsultime, me qëllim që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të mundësohet zhvillimi i këtij instrumenti politik në mënyrë efikase. Të dhënat e mbledhura i nënshtrohen një faze të dytë, verifikimit të të dhënave, për të siguruar saktësinë dhe përputhshmërinë e

tyre me burimet zyrtare dhe metodologjitë e aprovuara.

Në vijim, kryhet një analizë e detajuar e sektorëve, përfshirë identifikimin e potencialeve të kursimit të energjisë dhe masave specifike që mund të zbatohen. Analiza e të dhënave sasiore pasohet nga një rishikim fillestar i energjisë, ku përcaktohen sektorët më kritikë që kërkojnë ndërhyrje dhe investime.

Pasi është bërë verifikimi i të dhënave dhe analiza e detajuar e sektoreve, bëhet vendosja e objektivave, duke marrë në konsideratë politikat kombëtare të energjisë, potencialin lokal për përmirësime dhe qëllimet e përgjithshme të reduktimit të emetimeve të gazeve serrë.

Bazuar në këto përfundime, kalojmë në fazën e hartimit të planit, ku përpilohet një dokument gjithëpërfshirës që përmban masat konkrete, burimet e financimit dhe treguesit e monitorimit për efikasitetin e energjisë.

Përpara miratimit nga Këshilli Komunal, plani i përgatitur i nënshtrohet një procesi konsultimi me aktorët institucional, si dhe me përfaqësues të grupeve të interesit dhe shoqërisë civile. Ky proces siguron përputhjen e planit me nevojat lokale dhe politikat kombëtare. Pas përfundimit të konsultimeve dhe përfshirjes së komenteve të marra, plani final dërgohet për miratim në Këshillin Komunal.

I gjithë ky proces zhvillohet në mënyrë paralele me punën kërkimore të ekipit të konsulentëve për përmirësimin e metodologjisë për vlerësimin e

komponentëve të matjes së CO2 dhe potencialit për reduktimin e tij në çdo fushë

ku ndërhyhet me masat e efijencës së energjisë dhe klimës.

3. GJENDJA EKZISTUESE DHE KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË TERRITORIT

3.1 Pozicionimi Gjeografik, Relievi dhe Veçoritë Fizike të Territorit

Komuna e Junikut është pjesë e Republikës së Kosovës dhe ndodhet në pjesën perëndimore të saj, afër lindjes së Alpeve Shqiptare. Ajo ka një sipërfaqe prej 77.77 km² dhe territori i saj shtrihet në mënyrë gjatësore deri në veri-perëndim të fushës së Dukagjinit, duke kaluar nga një terren kodrinor në një reliev tipik malor. Nga ana jug-lindore, territori i komunës zgjerohet në formën e një hinke, një formë që theksohet edhe më shumë nga relievi kodrinor i përbërë nga kodrat periferike të Moronicës dhe Rogopeçit. Zona është e karakterizuar nga terren me pjerrësi të vogël, i ndërprerë nga përrenj të vegjël që sjellin ujë nga lartësitë dhe e shpërndajnë atë në fushë. Trupat kryesorë ujorë të zonës janë lumenjtë e Erenikut dhe Travës.

Nga pikëpamja administrative, Komuna e Junikut kufizohet me Komunat e Deçanit dhe Gjakovës, si dhe me Republikën e Shqipërisë dhe Malin e Zi në pjesën veriore të saj. Sa i përket distancave dhe aksesit, komuna është e lidhur me dy rrugë kryesore: Junik-Pejë (25 km) dhe Junik-Gjakovë (20 km).

Komuna e Junikut ka një pozicion gjeografik të përshtatshëm, pranë grykës piktoreske të lumit Erenik. Lartësia mbidetare e Junikut variaton nga 450 deri në 600 metra mbi nivelin e detit, ndërsa vetë qyteza e Junikut ndodhet në lartësinë 593 m. Maja më e lartë e territorit është Gjeravica, me lartësi mbidetare 2656 m, që është gjithashtu pika më e lartë në Kosovë dhe Alpet Shqiptare.

Figura 1. Harta fizike e territorit dhe relievi i Komunës Junik



Burimi: Komuna Junik, përpunuar nga CoPlan 2024

Dy maja të tjera të larta afër Gjeravicës janë Maja e Gusanit (2539 m) në pjesën perëndimore dhe Maja e Rrupës (2501 m) në pjesën veriperëndimore.

Territori i komunës ka formën e një gryke natyrore, përmes të cilës kalon Lumi i Erenikut, i cili rrjedh nga Gjeravica drejt Alpeve. Kjo larmi terreni bën që Juniku të jetë një zonë shumë e pasur me peisazhe mahnitëse, të cilat përfshijnë peisazhe hidrografike (lumenjtë Erenik dhe Travë), peisazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peisazhe kodrinore dhe malore (Gjeravica, Maja e Gusanit, Maja e Rrupës, Rrasa e Zogut, Jedova, Moronica).

3.2 Zhvillimi i Territorit dhe i Vendbanimeve

Komuna e Junikut ka tre vendbanime: qytezën e Junikut dhe dy fshatrat, Jasiq dhe Gjocaj. Zona urbane e komunës së Junikut ndodhet në pjesën juglindore të komunës, aty ku territori është më i ulët në lartësinë mbi nivelin e detit. Rritja urbane e këtij vendbanimi është vërejtur në pjesën e Junikut të Ri, mbi lagjen “Agim Ramadani” dhe përreth disa bërthamave që janë aktualisht qendrat e lagjeve të sotme me origjinë fisnore. Qyteza e Junikut ka gjithsej 12 njësi urbane, nga të cilat 10 janë të banuara, ndërsa 2 janë zona natyrore dhe bujqësore. Kjo e bën Junikun një vendbanim policentrik. Njësia Gacafer mund të përjashtohet nga kjo tipologji, pasi ka një shtrirje lineare të orientuar kah lumi i Erenikut. Me kalimin e viteve, shtrirja e këtyre njësive ka tentuar bashkimin e tyre, por ende nuk është bërë i mundur për shkak të hapësirave të gjelbërta mes tyre, të cilat përdoren për kullota ose prodhime bujqësore.

Fshatrat Jasiq dhe Gjocaj, që zënë një sipërfaqe prej 308 ha, janë gati plotësisht të zbrazura nga popullata, me vetëm 7 shtëpi të banueshme. Banorët e këtyre fshatrave janë vendosur kryesisht në lagjen “Agim Ramadani”. Arsyet për largimin e banorëve përfshijnë zhvendosjen nga lufta e fundit, mungesën e infrastrukturës fizike dhe sociale,

kërkimin e kushteve më të mira të jetesës në qytet, dhe rrezikun e mbetjeve të minave, që ende mbetet një problem i madh. Si rezultat, rreth 79% e popullsisë së komunës së Junikut jeton në zonën urbane të Junikut.

Njësia Urbane e Banimit dhe Funksioneve Administrative-Shërbyese

Njësia Urbane e Banimit dhe Funksioneve Administrative-Shërbyese ndodhet në lartësi mbidetare prej 450-600 m dhe përfshin Zonën Urbane me një sipërfaqe prej 520 ha. Kjo është një zonë administrativë, arsimore, banuese, si dhe për shërbime sociale dhe ekonomike-tregtare. Sipas të dhënave të studimeve të mëparshme, pjesa më e madhe e sipërfaqes së kësaj njësie është zonë e gjelbër dhe banuese (rreth 504 ha), ndërsa pjesa tjetër zë funksionet ekonomike-tregtare, shërbimet sociale dhe të tjera shërbime. Tipi i ndërtesave të banimit është kryesisht individual dhe kolektiv, me oborre të mëdha, brenda të cilave zhvillohen edhe aktivitete bujqësore, depozitimi i materialeve, etj. Aktualisht, struktura e prodhimit bujqësor në këtë zonë dominohet nga kultura e misrit dhe e grurit, që së bashku zënë rreth 40% të sipërfaqes së tokës së punueshme, ndërsa pjesa tjetër është livadh.

Sa i përket situatës së pronësisë, një numër i konsiderueshëm i pronave komunale (Juniku ka gjithsej 159,324 m² nga sipërfaqja urbane) është parë si një potencial i mundshëm për investime në krijimin e hapësirave publike. Pjesa më e madhe e pronave në këtë njësi është në pronësi private (5,059,085 m²) dhe karakterizohet me forma të çrregullta, me parcela të formave dhe madhësive të ndryshme. Brenda territorit të qendrës, mund të dallohen parcela minimale prej 200-300 m² dhe maksimale prej 6,000-7,000 m². Pronat publike kryesisht janë ish-prona të ndërmarrjeve shoqërore që janë në proces të ndryshimit të pronësisë. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht përgjatë lumit Erenik dhe në pjesën veriore të qendrës. Për shkak të statusit transitor që përfaqëson ky tip pronësie, ato mund të paraqesin mundësi

për përdorim për shërbime dhe hapësira publike.

Banimi dhe Ndërtimet


Komuna e Junikut ka gjithsej 1,427 ndërtesa në Zonën Urbane dhe 38 ndërtesa në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj, sipas të dhënave të Entit Statistikor. Të dhënat më të hollësishme mbi banimin në Zonën Urbane ofrohen nga PZHU, sipas të cilit zona e banimit në zonën urbane zë sipërfaqe prej 121,99 ha, që përbën 23% të sipërfaqes urbane. Në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1981, banimi zë sipërfaqe prej rreth 36 ha.

Lloji dhe tipologjia e ndërtesave të banimit në Junik dominohen nga ato të tipit individual

dhe të rrethuara me oborr përkatës, i cili ka hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin e funksioneve të tjera përveç atij të banimit, si bujqësia dhe blegtoaria, parkimi, depozitimi i produkteve, etj.

Komuna e Junikut ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm ndërtesash që prezantojnë vlera të trashëgimisë kulturore, siç janë kullat dhe shtëpitë e gurit, të cilat janë elaboruar më gjerësisht në pjesën e trashëgimisë kulturore. Gjendja aktuale e këtyre ndërtesave nuk është e mirë për shkak të ndërhyrjeve që janë bërë për përmirësimin e kushteve të banimit dhe shkatërrimeve të shkaktuara gjatë luftës, që kanë çuar në humbjen e disa prej tyre. Kjo e bën ruajtjen dhe mbajtjen e këtyre ndërtesave në funksion të banimit një aspekt sfidues.

Figura 2. Harta e përdorimit të tokës Komuna Junik



Burimi: Komuna Junik, përpunuar nga CoPlan 2024

Lartësia në Kate dhe Dendësimi i Banimit

Duke marrë parasysh tendencat aktuale që tregojnë zvogëlimin e ekonomive familjare dhe rritjen e popullsisë kombëtare me rreth 1.4% në vit, Juniku pritet të ketë një popullsi prej rreth 4,200 banorësh rezidentë deri në

vitin 2029, pa përfshirë diasporën. Ky trend sugjeron nevojën për një rritje të fondeve të banimit. Analizat nga studimet territoriale të mëparshme rekomandojnë një dendësim të banimit brenda sipërfaqeve ekzistuese të lagjeve, pa ndërtime të larta. Dendësimi parashikohet kryesisht në zonën qendrore

të Junikut, me një koeficient ndërtimi prej 45%, ndërkohë që rritja e etazhitetit mund të arrihet deri në 10 kate, por kjo mund të realizohet vetëm nëse shfrytëzohen hapësirat e pashfrytëzuara brenda parcelave apo ato që përdoren për funksione të tjera shërbimi. Kjo gjithashtu nënkupton se pjesa e banimit (sidomos përdhesa) mund të shfrytëzohet për aktivitete ekonomike.

Në zonat periferike të Junikut, nga qendra urbane, PZHU propozon një dendësim të lehtë, me koeficient ndërtimi prej 35%, që është 5% më i lartë se ai ekzistues. Ky dendësim mund të kontribuojë në rritjen e kapacitetit të banimit, duke ruajtur karakterin e zhvillimit të kontrolluar dhe të qëndrueshëm.

Ndërtimet pa Leje


Përveç kësaj, fenomeni i ndërtimit pa leje është i pranishëm në Junik, ashtu si në shumë zona të tjera të Kosovës, sidomos në zonën urbane. Studimet sugjerojnë zhvillimin e një vlerësimi mbi ndërtimet pa leje dhe

krijimin e një baze të dhënash që do të përmbajë informacionet për secilën ngastër, lidhur me statusin formal të ndërtimit dhe posedimit të lejes. Ky proces do të ndihmojë në përcaktimin e kriterëve për legalizimin apo mos-legalizimin e ndërtesave. Komuna e Junikut ka filluar trajtimin e ndërtimeve pa leje në përputhje me ligjin për trajtimin e ndërtesave të ndërtuara pa leje.

Boshatisja e Shtëpive në Jasiq dhe Gjocaj

Një problematikë tjetër është boshatisja e shtëpive në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj dhe zhvendosja e popullsisë në zonën urbane (lagjen "Agim Ramadani"). Aktualisht, në këto dy fshatra jetojnë vetëm 7 familje. Kthimi i popullsisë në këto vendbanime është i lidhur ngushtë me investimet në infrastrukturën fizike dhe sociale, si dhe me eliminimin e rrezikut të minave, i cili është ende prezent në këtë zonë. Kjo kërkon një angazhim të veçantë për të krijuar kushte të sigurta dhe funksionale që mundësojnë ripopullimin e këtyre fshatrave.

Figura 3. Harta e ndërtimeve në Komunën e Junikut




Burimi: Komuna Junik, përpunuar nga CoPlan 2024

3.3 Tendencat e Popullsisë

Sipas statistikave të vitit 1981 dhe disa shënimeve të pasluftës, kur Juniku u themelua si Pilot Njësi Komunale, ky vendbanim numëronte rreth 12,500 banorë, duke përfshirë fshatrat Gjocaj, Jasiq, Voksh, Sllup dhe Rastavicë. Në vitin 2008, me miratimin e Kushtetutës dhe Ligjit për Kufijtë

Administrativë, Juniku u bë komunë me dy zona kadastrale: zona kadastrale e Junikut dhe zona kadastrale e Gjocajt dhe Jasiqit. Në këtë periudhë, popullsia e komunës është vlerësuar të jetë rreth 9,600 banorë, përfshirë diasporën, sipas të dhënave nga Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Figura 4. Harta e dendësisë së popullsisë në Komunën e Junikut



Burimi: Komuna Junik, përpunuar nga CoPlan 2024

Të dhënat e fundit zyrtare nga ESK (2011), tregojnë se Juniku si vendbanim sipas regjistrimit 2011 ka 766 ekonomi familjare, respektivisht 804 të përlogaritura për vitin 2023. Sipas administratës tatimore dalin se janë 1,219 ekonomi familjare. Numri

banorëve është 6,370 sipas ASK, 770 objekte ndërtimore, kurse fshatrat Jasiq- Gjocaj kanë 2 ekonomi familjare me gjithsej 7 anëtarë dhe 38 objekte ndërtimore. Mesatarja e ekonomive familjare është 6 anëtarë për familje.

Tabela 1. Popullsia e Junikut gjatë viteve (Burimi: ESK)

		Popullsia							
		1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2024
1	Gjocaj	210	180	138	161	215	306	31	18
2	Jasiq	231	376	190	251	295	306		0
3	Junik	2391	2439	3024	3445	4553	5490	6053	3925
	Gjithsej	2832	2995	3352	3857	5063	6102	6084	3943
		Ekonomitë Familjare							
		1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2024
1	Gjocaj	34	24	18	25	24	40	4	3
2	Jasiq	27	56	24	29	30	33		
3	Junik	378	385	462	460	541	690	766	892
	Gjithsej	439	465	504	514	595	763	770	895

Shënim: Të dhënat për vitin 2024 janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për popullsinë sipas moshës dhe gjinisë. Më se 37% e popullsisë janë nën moshën

20 vjeçare. Raporti gjinor është pothuajse i balancuar (F:M=50.40%: 49.60%). Popullsia i përket etnisë shqiptare.

Tabela 2. Popullsia sipas moshës dhe gjinisë

Vendbanimet	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Gjinia	
	0- 14 vjec	15- 19 vjec	20- 64 vjec	≥ 65 vjec	M	F
Gjocaj	1	0	14	3	8	8
Jasiq	0	0	0	0		
Junik	676	311	2,406	532	1,968	1,957
Gjithsej në komunë	677	311	2,420	535	1,976	1,965
Meshkuj	360	171	1,213	233		
Femra	317	140	1,207	302		
Përqindja	17%	8%	61%	14%		

Shënim: Të dhënat për vitin 2024 janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Trendi dhe prognoza demografike: Popullsia e Junikut paraqitet mjaft “delikate” ndaj ndryshimeve ekonomike sado të vogla qofshin ato, apo edhe nga faktorë të jashtëm të cilët influencojnë zhvillimet demografike dhe ekonomike në qytezë. Sipas parashikimeve të mëhershme të bazuara në të dhëna aktuale, vlerësimi i rritjes së popullsisë tani duket më i vogël dhe bazuar në vlerësimet e ASK-së për nivel të Kosovës, pritet që në vitin 2028 të arrihet vlera maksimale, me mundësi reale që pas këtij viti të ketë stagnim apo edhe zvogëlim të vogël të popullsisë. Zhvillimi ekonomik tani është më i rëndësishëm se asnjëherë më parë për të ndaluar dhe krijuar kushte dhe mundësi të kthimit të diasporës. Por, pavarësisht kësaj, mund të thuhet se Juniku është vendbanim në zhvillim me mundësi reale për t’u ndërtuar dhe zhvilluar, prandaj është i domosdoshëm kontrolli dhe udhëzimi i këtij zhvillimi.

Parashikimi demografik i bazuar në metodologjinë dhe të dhënat aktuale statistikore pritet të jetë më së shumti rreth 7,400 banorë në vitin 2029. Këto të dhëna bazohen në numrin e popullsisë rezidente. Ky numër sigurisht do të jetë më i madh nëse do të krijohen kushte dhe mundësi të reja të zhvillimit dhe tërheqjes sidomos të diasporës me oferta dhe mundësi konkrete.

3.4 Klima dhe Ndikimi në Prodhimin e Energjisë nga Panelet Diellore

Juniku ka klimë kontinentale, por, me disa tipare mesdhetare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Mesatarja e temperaturës është 21° C në verë dhe -11° C në dimër. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm³, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm³.

Përgjatë viteve, ndryshimet klimatike kanë shkaktuar luhatje më të mëdha të temperaturave, përfshirë vera më të nxehta dhe dimra më të ashpër, si dhe një rritje të fenomeneve ekstreme, si valët e të nxehtit dhe reshjet e dendura.

Në lidhje me ekspozimin ndaj diellit, Juniku përfiton nga një mesatare prej 4.5 deri në 5 orë diell kulmor në ditë. Kjo e bën zonën të përshtatshme për projekte të energjisë diellore fotovoltaike (PV). Potenciali për prodhimin e energjisë nga panelet PV vlerësohet të jetë rreth 1,350 deri në 1,700 kWh/m² në vit, çka mund të shfrytëzohet për gjenerimin e energjisë së qëndrueshme.

3.5 Shërbimet Publike dhe Shpërndarja e Tyre

Në këtë kapitull zhvillohet një analizë e detajuar e shërbimeve publike të cilat mbështeten nga pushteti vendor në Republikën e Kosovës, e më konkretisht në Komunën e Junikut duke evidentuar problematikat në lidhje me këto shërbime. Analizimi i këtyre shërbimeve lidhet në mënyrë direkte me konsumin e energjisë në nivel vendor e po ashtu edhe me emetimin e gazërave serrë. Konkretisht lëvizshmëria e automjeteve apo konsumi energjetik në institucionet publike lidhet direkt me politikat e manenaxhimit të efijencës së energjisë.

Ujësjiellësi - Rrjeti i ujësjiellësit është në gjendje mesatarisht të mirë. Ka mjaft burime të pastërta ujore të cilat momentalisht shfrytëzohen dhe 97% e banorëve furnizohet me ujë të pijshëm nga ujësjiellësi. Në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj rrjeti i ujësjiellësit nuk është i organizuar, por ato furnizohen me ujin nga burimet natyrore që vjen me rënie të lirë. Rrjeti ka afërsisht 15 km tuba të ujit në gjendje të mirë dhe 1.4 km në gjendje më të dobët. Aktualisht ujësjiellësi i Junikut menaxhohet nga KUR "Hidrodrini" nga Peja, nëpërmjet Njesisë Operative në Junik. Furnizimi me ujë të pijshëm është i mirë me përjashtim të muajit gusht dhe shtator ku ka edhe reduktime të ujit. Ka edhe mjaft burime tjera të ujit për pije por në mungesë të donacioneve kanë mbetur të pa shfrytëzuara. Cilësia e ujit që përdoret në Junik është jashtëzakonisht e mirë (ku edhe është vërtetuar me analizat e bëra të ujit).

Qyteza e Junikut furnizohet me ujë të pijshëm prej katër burimeve:

- Nga Burimi i quajtur "Burimi i Goçit" (gati tërë qyteza furnizohet prej këtij burimi dhe ku cilësia e ujit është më e mira, furnizimi bëhet me 30 l/sec. Në sezon të verës kur ka reduktime niveli i ujit bie, furnizimi bëhet me 14 l/sec. ndërsa depoja e rezervoarit ka kapacitet prej 600 m³ ujë. Burimi i "Burimi i Goçit" gjendet në lartësinë mbidetare 1200 m.

- Burimi Livadhi i Madh i cili gjendet në lartësin mbidetare 1280m, ku cilësia e ujit është shumë e mirë.
- Nga burimi i quajtur "Lipovica" (furnizohet një pjesë e Lagjes Gacafer, 7 shtëpi). Është njeri nga burimet me të vjetra, gjegjësisht 40 vjet i vjetër. Ky burim ka kapacitet të furnizimit 6-16 l/sec. Nga ky burim nuk ka reduktime të furnizimit me ujë.
- Nga burimi në Shkozë (furnizohet e tërë Lagja "Agim Ramadani" dhe një pjesë e Lagjes së Shalajve, Gaxherr dhe "Dëshmorët e Kombit", rreth 1500 banorë).

Burimi Vrella e Goçit është burimi më aktiv, përderisa dy burimet tjera janë të vjetra dhe kanë kapacitet më të vogël furnizimi. Nevoja elementare për kokë banori në Junik është 200 l/ditë. Në të ardhmen e afërt, parashihet që të rritet sasia e furnizimit me ujë edhe nga burimet tjera ekzistuese të cilat tash nuk shfrytëzohen. Burim tjetër që do të mund të shfrytëzohet në të ardhmen është Burimi i Livadhit të Madh e cila ka kapacitet për të mbuluar edhe fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

Kanalizimi - Rrjeti i ujërave të zeza është në gjendje relativisht të mirë. Ky rrjet e mbulon pothuajse gjithë territorin e banuar të komunës. Megjithatë, në fshatrat Gjocaj dhe Jasiq nuk ekziston ende një rrjet kanalizimi. Ujërat e zeza derdhen në natyrë, por aktualisht nuk ka banorë që jetojnë në këto fshatra, prandaj ky problem nuk ka impakt të drejtpërdrejtë.

Megjithatë, është e rëndësishme që në të ardhmen, me mundësinë e rijetëzimit të këtyre fshatrave, të mendohet për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm kanalizimi, për të parandaluar ndotjen dhe për të siguruar kushte të mira higjienike për banorët e mundshëm.

Menaxhimi i Mbeturinave - Në Komunën e Junikut, Shërbimi i Grumbullimit të

Mbeturinave dhe Pastrimit të Rrugëve ofrohet nga kompani private, pasi nuk ka ndërmarrje publike, dhe është i shtrirë 100% në territorin e Komunës së Junikut dhe ofrohet katër herë në javë derë më derë, ku 98% e ekonomive familjare janë të futura në shërbim.

Nga viti 2024 Komuna e Junikut në bashkepunim me GIZ Gjerman ka filluar pilot projektin për ndarje në burim të mbeturinave, të shisheve të plastikës, të letrës, të kartonit. Ky projekt ka filuar në lagjen Agim Ramadani, në institucionet publike dhe bizneset private, si gjeneruse më të medha të mbeturinës letër dhe karton.

Komuna e Junikut ka “Rregullore për menagjim të mbeturinave”, “Planin komunal për menagjim të mbeturinave”, si dhe nga viti 2025 ka hartuar “Planin ndërkomunal për menagjim të integruar të mbeturinave”, i cili është pjesë e projektit për menagjim të

integruar të mbeturinave që financohet nga banka Gjermane dhe do të implementohet në Komunën e Dukagjinit.

Komuna e Junikut për disa vite rresht është shpallur si komuna më e pastër në Kosovë.

Sistemi i ngrohjes - Ngrohja në Junik nuk kryhet me një sistem qendror, por operon në baza individuale dhe kryhet në masë të madhe me lëndë drurore dhe energji elektrike. Kjo natyrisht që ka pasoja në humbjen e masës drusore në pyjet e Junikut dhe ndotjen e mjedisit e cila është një sasi e shtuar e prodhimit të gazeve të efektit serrë.

Infrastruktura rrugore - Korridoret dominuese rrugore në komunën e Junikut janë rrugët regjionale të cilat lidhin Junikun me qendrat më të afërta si Deçani, Peja dhe Gjakova. Gjendja fizike e këtyre akseve është relativisht e mirë, dhe përmes tyre përballohet ngarkesa e trafikut të shkallës së mesme.


Tabela 3. Rrjeti rrugor

Kategoria e rrugës	Nr	Rrugët	Gjatësia m	Gjendja fizike	Trafiku
Rrugë regjionale: (pë mirëmbajtjen e të cilave është përgjegjëse MI)	3	1) Junik-Voksh-Deçan e cila bën lidhjen me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë që çon në Deçan dhe Pejë 2) Junik-Rastavicë lidhet përsëri me rrugën Pejë-Gjakovë nga ana e Gjakovës 3) Junik-Batushë- Ponoshec bën lidhjen me fshatrat malore në jug-perëndim të tij dhe me qytetet e Shqipërisë së Veriut dhe Gjakovë	9,558	1)Relativisht e mirë 2)Relativisht e mirë 3)Relativisht e mirë	1)Relativisht i ngarkuar 2)Trafik i mesëm 3)Trafik i lehtë
Rrugë kryesore komunale: (janë rrugë që lidhin qendrat e bashkësive lokale me sub-qendrat më të afërta)	1	1) Rruga Junik-Dobrosh-Gjakovë që lidh qendrën me fshatrat e pjesës juglindore duke vazhduar për në Gjakovë. 2) Rruga Junik-Pacaj-Gjakovë që lidh qendrën me fshatrat e pjesës juglindore duke vazhduar për në Gjakovë. 3)Rruga Junik-Nivokaz-Gjakovë që lidh qendrën me fshatrat e pjesës juglindore duke vazhduar për në Gjakovë. 4) Rruga Junik-Heriq-Gjakovë që lidh qendrën me fshatrat e pjesës juglindore duke vazhduar për në Gjakovë. 6) Rruga Junik – Gjeravice qe lidh qendrën me fshaterat Gjocaj dhe Jasiq dhe Bjeshket e Gjeravices. 7) Rruga Junik-Prelep-Drenoc-Deçan që lidh qendrën me fshatrat e pjesës veriper-endimore duke vazhduar për në Deçan.	3,596	Relativisht e mirë	Trafik i lehtë

Kategoria e rrugës	Nr	Rrugët	Gjatësia m	Gjendja fizike	Trafiku
Rrugë lokale: (rrugë që lidhin hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të komunës)	25	1) Rrugët që lidhin lagjet	22,000	Jo e mirë/ të pa kategorizuara	Trafik rural
Rrugët sezonale		Rrugët që përdoren gjatë sezonit veror për qasjen në tokat bujqësore			

Burimi: Komuna Junik 2024

Figura 5. Harta e Infrastrukturës së aksesit në Komunën e Junikut



Burimi: Komuna Junik, përpunuar nga CoPLAN 2024

Nga tabela e mësipërme paraqitet si rrjet të matur kemi një gjatësi prej 35.1 kilometrash linear, por nga analiza e realizuar me anë të sistemit GIS kemi një gjatësi prej 213.5 km linear nga të cilat 40 km janë rrugë rezidenciale. Nga kjo gjatësi e rrjetit total të rrugëve rreth 55 km linearë janë të ndriçuara ose rreth 25.8% e rrjetit total, e cila është një indikator mjaft i lartë në raport me gjatësinë totale të rrjetit rrugor. Sa i përket gjendjes së aksesit në vendbanime kryesisht këto rrugë janë të aksesueshme mirë dhe kanë gjendje të mirë fizike. Problematikat më të theksuara të aksesit janë në zonat malore në veri – perendim të vendbanimit të Junikut të cilat përdoren për arsye turistike. Mungesa e infrastrukturës dhe e sinjalistikës ka krijuar vështirësi për udhëtarët dhe vizitorët, duke e bërë të vështirë orientimin dhe qasjen e lehtë në këto atraksione natyrore.

Transporti publik

Transporti me autobus: Në komunën e Junikut transporti publik i brendshëm nuk funksionon. Por, në këtë komunë funksionon transporti i nxënësve si dhe linja e autobusëve ndërkomunalë dhe për arsye të mungesës së stacionit të autobusëve, ata stacionohen në qendër. Përmes këtyre autobusëve udhëtarët lëvizin në drejtime të ndryshme si të fshatrave për rreth ashtu edhe në qytetet tjera. Pra, ka linja të rregullta udhëtimi për Deçan, Gjakovë, Pejë e Prishtinë.

Lidhje të drejtpërdrejta dhe të shpejta janë të orientuara drejt Deçanit e Pejës. Gjakova mund të arrihet më shpesh duke pasur parasysh që shërbimet për në Deçan edhe më tutje veprojnë përmes rrugës magjistrale ku udhëtarët mund të lidhen me shërbimet e rregullta që udhëtojnë në drejtimin mes Pejës dhe Gjakovës.

Tabela 4. Lidhjet e transportit ndërrurban

Lidhja	Numri i nisjeve	Distanca km	Koha e udhëtimit (min)
Junik-Deçan-Pejë-Prishtinë	13	110	20 / 35 / 120
Junik-Deçan-Pejë	9	12,5 / 28,0	20 / 35
Junik-Batushë-Gjakovë	9	2 / 25,5	20 / 40
Junik-Rastavicë-Gjakovë	3	5.5 / 22,5	15 / 45
Junik-Gjakovë nëpërmjet shërbimeve të Deçanit dhe lidhjes në linjën kryesore rrugore	22	23	40

Burimi: Komuna Junik 2024

Transporti hekurudhor: Në territorin e komunës së Junikut nuk kalon linja hekurudhore. Kjo linjë nuk kalon as pranë këtij territori. Stacioni më i afërt i trenit ndodhet në qytetin e Pejës dhe të Klinës. PZHK i Gjakovës parasheh lidhjen hekurudhore me Deçanin dhe Pejë, e cila do të kalojë paralel me rrugën regjionale Gjakovë-Deçan-Pejë dhe kjo paraqet një mundësi për Junikun të kyçet në linjat hekurudhore në të ardhmen. Shërbimet Taxi : Në Junik shërbimet taksi ofrohen nga vetura taksi të regjistruara të cilat operojnë sipas kohëve të parashikuara.

Në përmbledhje të këtij seksioni, vlerësohet se mungesa e rrugës tranzit që do të shërbente për transport të rëndë, si dhe rrjeti i brendshëm i rrugëve ende i pakompletuar, paraqesin pengesa të mëdha për zhvillimin e transportit dhe lëvizshmërisë. Aksesit deri në bjeshkë mbetet i vështirë, megjithatë, së fundmi është lehtësuar, por mbetet ende një sfidë. Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për transport publik, si stacionet e autobusëve, dhe ofrimi i kushteve më të mira për lëvizjen e banorëve (shtigje këmbësorësh, trotuare, sinjalizime etj.) janë gjithashtu probleme të tjera të rëndësishme.

Për më tepër, zhvillimi i turizmit, që shihet si një mundësi e ardhshme për komunën, kërkon vëmendjetë veçantë për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse, si rregullimi i vijave të ecjes deri në zonat turistike,

krijimi i vendkampingjeve dhe përmirësimi i kushteve të tjera për turistët. Ky përmirësim infrastrukturual do të mundësojë një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit dhe një rritje të cilësisë së jetesës për banorët.

3.6 Shërbimet Sociale dhe Standardi i Jetesës në Komunën e Junikut

Në këtë plan, një aspekt shumë i rëndësishëm është analiza e shërbimeve sociale në nivel vendor, që ka për qëllim të kuptohet qartë situata dhe problematikat me të cilat përballet komuniteti i Junikut. Kjo analizë ndihmon në identifikimin e sfidave që lidhen me problematikat sociale, të cilat mund të përkthehen gjithashtu në sfida në lidhje me energjinë. Një shembull i tillë është problematika e varfërisë energjitike, e cila përbën një çështje të rëndësishme për territorin e komunës së Junikut dhe kërkon masa të veçanta për të siguruar qasje të barabartë në energji për të gjithë banorët.

Punësimi dhe papunësia: Ashtu sikur në tërë Kosovën, shkalla e papunësisë edhe në Komunën e Junikut është e lartë dhe paraqet një aspekt shqetësues. Nga të dhënat e marra në terren del se nga popullsia aktive për pune (të moshës 19-64 vjeç), vetëm 22.76% e tyre janë të punësuar, ndërsa 77.24% e e tyre është e papunë. Nga 22.76% e të punësuarve, 4.03% janë femra ndërsa 18.73% meshkuj që do të thotë se raporti i punësimit sipas gjinisë është gati F:M=1:5.

Në mungesë të punësimit në kapacitete të mirëfillta prodhuese një numër i të punësuarve kanë gjetur mundësinë e punësimit në bizneset e vogla private. Përveç mosfunksionimit të kapaciteteve prodhuese, faktorë tjerë që kanë ndikuar më së shumti në rritjen e shkallës së papunësisë janë:

- Procesi i privatizimit (Pronat e Ndërmarrjes Shoqërore Ereniku)
- Kushtet e vështira gjeografike dhe ekonomike
- Mungesa e investimeve në infrastrukturë
- Mungesa e investimeve në sektorin e bujqësisë

- Mungesa e politikave të nivelit Qendror në krijimin e vendeve të reja të punës

Të dhënat komunale për vitin 2019, tregojnë se numri i të punësuarve në sektorin publik është 163. Krahasuar me vitin 2009, numri i shërbyesve civil është rritur për 22 persona.

Të ardhurat: Të ardhurat kryesore vijnë nga përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale, dhe operimi i kompanive të vogla të ndërtimit. Mirëpo duke pasur parasysh numrin e madh të junikasve që gjenden jashtë vendit, konsiderohet që ndihma ekonomike që vjen nga jashtë përbën gjithashtu një burim të ardhurash të rëndësishme për komunën. Rezultatet mbi të ardhurat mesatare familjare janë si vijon:

Varfëria dhe asistenca sociale: Sipas të dhënave nga Qendra për Punë Sociale e Komunës së Junikut, gjithsej janë 170 individë (57 familje) rezidentë në Junik që jetojnë në varfëri. Kjo vlerë tregon se kemi të bëjmë me shkallë të mesme të varfërisë. Rritjes së shkallës së varfërisë i kanë kontribuar: shkalla e lartë e papunësisë, shkatërrimi masiv gjatë luftës, sidomos për vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, etj.

Nga një normë mjaft e lartë e papunësisë, si dhe nga norma e vafërsirë që rezulton në 57 familje mund të analizohet si e tillë edhe varfëria energjitike, duke studiuar komfortin termik në këto familje po ashtu edhe përqendrimin më të madh në territor të këtyre familjeve. Duhet të ketë një program të veçantë për përmirësimin e kushteve të banimit në banesa, në mënyrë që të kemi një cilësi jetese më të mirë për të gjithë shtresat sociale në territorin e Junikut.

Strehimi: Komuna e Junikut nuk ka probleme të pastrehëve dhe e gjithë popullata kanë strehim të përshtatshëm, duke marrë parasysh edhe atë se Lagjja "Agim Ramadani" është duke u shfrytëzuar në një formë si banim social dhe strehim për banorët e zhvendosur nga fshatrat Jasiq dhe Gjocaj.

Migrimi: Në mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk dihet numri i saktë zyrtar i familjeve që jetojnë në diasporë. Sipas statistikave del se më tepër se 50% e popullsisë së Junikut jeton jashtë Kosovës dhe interesimi për të migruar jashtë në kërkim të kushteve më të mira për jetë dhe gjetjen e mundësive për punësim është ende prezent.

Organizimi i shoqërisë civile: Shoqëria civile në komunën e Junikut nuk është mirë e organizuar dhe si e tillë nuk është edhe shumë aktive. Ndoshta një gjendje e tillë ndodh për shkak se Juniku është komunë e re dhe se deri më tani nuk ka pasur kapacitete të zhvillohet ky sektor.

Gjendja në arsim dhe shërbimet arsimore

Procesi edukativo-arsimor në Komunën e Junikut zhvillohet në nivelet: parashkollor (3-5), parafillor (5-6), përfshirë fëmijët me nevojë të veçanta, fillor (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (6-9) dhe arsimi i mesëm i lartë (X-XII).

SHML - Gjimnazi "Kuvendi i Junikut" në Junik është e organizuar në tri drejtime:

Drejtimi Shkencat Natyrore, Drejtimi Shkencat Shoqërore-Gjuhësore dhe Drejtimi i Mjekësisë së Përgjithshme, paralele e ndarë e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

Në vitin shkollor 2024/2025 do të kemi edhe drejtimin për Hotelieri dhe Turizëm. Në SHFMU "Edmond Hoxha" infrastruktura shkollore ekziston e mirë, duke pasur parasysh që kemi objektin e ri me sipërfaqe rreth 4,000 m²; në dhjetor të viti 2023 mësimi ka filluar në objektin e ri. Objekti i vjetër nr. 1 i shkollës është nën mbrojtje të përkohshme si trashëgimi kulturore, pasi objekti është liruar, dhe planifikohet të ketë rivendosje si objekt multifunksional. Ndërsa, objekti nr.2 i SHFMU, planifikohet që kati përdhësë të adaptohet në objekt për çerdhe-kopsht, punimet janë duke vazhduar, planifikohet që gjatë vitit 2024 të përfundojnë punimet.

Çerdhe-Kopshti për fëmijë për grupmoshat 3-5 vjeç është duke funksionuar në kuadër të SHFMU "Edmond Hoxha", ky institucion është krijuar edhe me ndihmën e organizatës Save the Children nga viti 2016. Fëmijët janë të sistemuar në një objekt i cili nuk i plotëson kushtet infrastrukturore për qëndrim tërë ditë, prandaj qëndrimi është prej orës 8:00-12:00. Mësimi në SHFMU organizohet në një ndërrim. Gjithashtu edhe mësimi në SHML (Gjimnazi) organizohet në një ndërrim vetëm paradite. Komuna akoma nuk e ka të organizuar transportin urban, prandaj Transporti i nxënësve është organizuar, nga

Tabela 5. Numri nivelet e arsimit në procesin edukativo-arsimor 2024-2025

Nr	Niveli shkollor	Nr. nxënësve	Mësimdhënës	Administrata	Sanitare
1	Parashkollorë	26	2	2	
2	Parafillor	26	1		
3	Fillor dhe i mesëm i ulët	399	936		5
4	Arsim i mesëm i lartë	160	16	1	3
5	P.me nevojë të veçanta	7	4		
Totali		663	59	3	8

Burimi: Komuna Junik 2024

lagjja Agim Ramadani-SHFMU dhe SHML dhe anasjelltas.

Mundësitë për edukimin e personave me nevoja të veçanta fizike ekzistojnë, mirëpo familjarët në shumicën e rasteve nuk i dërgojnë fëmijët në paralele për persona me nevoja të veçanta. Shënime për nivelin e analfabetizmit nuk ka meqë nuk janë bërë ende statistika për shkallën e analfabetizmit.

Sistemi për përkujdesje shëndetësore: Shërbimet shëndetësore parësore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila gjendet në qytetin e Junikut dhe numëron gjithsej 33 punëtorë të sistemuar në shërbim 24/7. Nga ky numër, nëntë (9) janë mjekë, dy (2) stomatologë dhe pjesa tjetër staf i mesëm dhe staf ndihmës.

QKMF ofron të gjitha shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor si dhe shërbime Stomatologjike. Qasja dhe gravitimi i banorëve deri tek QKMF është e lehtë, dhe madje shfrytëzohet edhe nga banorët e disa fshatrave të Deçanit dhe Gjakovës. Duke e marrë parasysh kriterin se për 2000 banorë nevojitet 1 mjek dhe 2 motra medicinale, QKMF në Junik e plotëson këtë kriter.

Kuadri aktual mjekësor i plotëson nevojat për shërbimet e nevojshme për dy ndërrime, mirëpo për mbulimin e shërbimit 24/7 jemi detyruar që të kontraktojmë shërbimet shëndetësore deri në plotësimin e stafit të nevojshëm. Shërbimet dytësore ofrohen nga spitalet rajonale të Pejës dhe Gjakovës.

Kultura, Rinia dhe Sporti: Në territorin e Junikut vërehet një mungesë e madhe e institucioneve për kulturë (muze, teatër, kinema), institucioneve dhe hapësirave për sport e rekreacion, si dhe hapësirave publike (parqe, sheshe etj).

Në kuadër të PZHU-së dhe PRRU-së për qendrën e komunës janë shqyrtuar projekte të cilat do të mundësonin krijimin e hapësirave për zbavitje, sport e rekreacion e të cilat do të mund të shfrytëzoheshin edhe nga banorët e fshatrave si:

- Plotësimi i strukturave arsimore (shkollave) me mjedise me funksion rekreativ (lulishte, kënd lodrash, terrene sportive),
- Krijimi i një hapësire për rekreacion sportiv
- Krijimin e Sheshit Publik, Bibliotekës Komunale dhe Muzeut të Qytetit.

Këto projekte janë duke u realizuar dhe do të kontribuojnë në përmbushjen e boshllëkut që ka komuna në lidhje me mungesën e hapësirave publike, si dhe hapësirave për sport dhe rekreacion. Kjo jo vetëm që do të përmirësojë cilësinë e jetesës për banorët e Junikut, por gjithashtu do të ofrojë mundësi të reja për vizitorët, duke i tërhequr ata përmes infrastrukturës së përmirësuar. Meqë turizmi shihet si një potencial zhvillimi për komunën, këto projekte janë një hap i rëndësishëm drejt shfrytëzimit të mundësive turistike dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Mediat lokale: Në Junik nuk ka ndonjë radio apo televizion lokal e as edhe ndonjë korrespondent të gazetave të përditshme kosovare. Prandaj, qytetarët e Junikut kryesisht informohen nga televizionet apo radiot publike dhe ato private të komunave përreth.

Në përmbledhje të këtij seksioni mund të vlerësohet se gjendja sociale në Junik në aspektin e varfërisë dhe strehimit sipas treguesve të dhënë është diç më e mirë krahasuar me trendin kosovar në përgjithësi, mirëpo, migrimi, punësimi i të rinjve dhe shkalla e lartë e papunësisë dhe ofrimi i infrastrukturës sociale dhe shërbimeve përkatëse më afër qytetarit mbesin ende një sfidë e veçantë për komunën e Junikut.

3.7 Ekonomia Lokale, Ndërmarrjet Ekonomike dhe Buxheti Komunal

3.7.1 Bujqësia dhe aktivitetet bujqësore në komunën e Junikut

Bujqësia: është veprimtari e rëndësishme në komunën e Junikut. Juniku ka 4.439 Ha tokë bujqësore e cila paraqet 57.08% të sipërfaqes

së përgjithshme. Ky është indeks relativisht i lartë krahasuar me mesataren në Kosovë që sillet prej 0.15-0.18 Ha tokë bujqësore për kokë banori (limiti kritik është 0.17 Ha) dhe atë në Europë (0.52 Ha/1b). Toka bujqësore pas luftës kultivohet me një shkallë më të ulët për shkak të konkurrencës joreale në treg dhe mos aplikimit i të mbjellurave nga fermerët. Aktivitetet bujqësore në Junik zhvillohen qoftë në zonën urbane (për shkak të tipologjisë së banimit me oborre të mëdha) po ashtu edhe atë rurale. Ndërsa kulturat më të zhvilluara bujqësore janë: gruri, misri, fasulja, thekra, pastaj perimet si: specat, domatet, lakrat dhe qepët. Në masë mesatare kultivohen kulturat e pemëtarisë si: molla, dardha, vishnja, dhe dredhëza, por kohëve të fundit shihet tendenca e rritjes së mëtejshme të sipërfaqeve të pemishteve, me një favorizim të rritjes së kapacitetit të ujitjes. Falë cilësisë së tokës dhe klimës, Juniku karakterizohet edhe me kulturat e bimëve me veti mjekuese si: lincuri, rrudhani dhe disa lloje të këpurdhave.

Blegtoria: Përkundër faktit që ajo pësoi

dëme shumë të mëdha gjatë luftës (dëmet rezultuan me humbjen e rreth 90% të gjedheve, 85% të deleve, 100% të pulave dhe rreth 50% të dhive) blegtoria paraqet një drejtim tjetër strategjik të zhvillimit ekonomik të Komunës së Junikut. Sipërfaqja e madhe me livadhe e kullota brenda territorit të komunës si dhe nga tradita e zhvillimit të kësaj larmie janë faktorë favorizues për zhvillimin e blegtorisë (sidomos në kultivimin e gjedheve dhe dhenve). Sipas të dhënave nga Strategjia Zhvillimore Lokale (2009), në Junik ekzistojnë 55 ferma të vogla dhe 66 ferma të mëdha të specializuara. Në territorin Komunal janë 300 gjedhe, 1200 bagëti e imtë, 1250 koshere bletësh.

Organizimi: Në këtë drejtim është me rëndësi të shikohen edhe çështjet nga aspekti institucional dhe organizativ. Stimulimi i bujqve dhe fermerëve nga ana e Ministrisë (MBPZHR) për rritjen e shfrytëzueshmërisë së tokës bujqësore respektivisht ngritjen e fermave duke respektuar standardet e BE-së.

Tabela 6. Numri i fermave sipas madhësisë

Fermat	Krerë lopë
Fermat e Vogla	10 -20 krerë
Fermat e Mesme	20-50 krerë
Ferma të Mëdha	mbi 50 krerë

Burimi: Komuna Junik 2024

Sipas informatave nga komuna e Junikut, mendohet se ekzistojnë rreth 954 dele të shpërndara në 7 fermerë dhe diku 250 lopë në rreth 30 fermerë të kësaj komune. Janë gjithsej 5 fermerë që kanë mbi 10 krerë lope qumështore të cilët kanë përfituar nga stimulimi i MBPZHR.

Sistemi i ujitjes së tokave bujqësore: Nën sistemin e ujitjes janë 960 Ha tokë punuese. Komuna në këtë aspekt është duke u ndihmuar nga Ministria e Bujqësisë dhe donatorët e tjerë dhe kane ndërtuar disa

penda në lumin Erenik dhe Trava, si dhe një pjesë të konsiderueshme të kanaleve të ujitjes. Me këto projekte janë futur në sistemin e ujitjes një pjesë e madhe e tokave bujqësore. Realizimi i këtij projekti pa dyshim që do ta përmirësojë pak situatën, por jo në tërësi. Ka nevojë për ngritjen e kanaleve që do ta dërgonin ujin në çdo pjesë të tokave bujqësore. Kështu fermerëve do t’iu lehtësohet puna për zënien e ujit nga lumi Erenik dhe futjen e ujit në sistemin e ujitjes. Ka vite që ujitja e tokave bujqësore bëhet nga ky lum meqë sasia e ujit është e

mjaftueshme për ujitje. Nevojitet që kanalet kryesore dhe ato ndihmëse të rregullohen dhe mirëmbahen.

Pylltaria: Sipërfaqja pyjore në Komunën e Junikut është rreth 3,444 hektar apo 43% të territorit të Komunës. Në pronësi private janë rreth 1315ha, rreth 22% e pyjeve. Rreth 50% e pyjeve janë të reja rreth moshës 30 vjeçare me lloje gjetherënëse (fletor) dhe lloje gjethembajtëse (halor). Nga llojet fletorë më të njohurat janë: Ahu, Gështenja; Dushqet, Shkoza, Mështekna, Panjat, Verri etj. Dominojnë pyjet e Ahut me 79 % të sipërfaqes pyjore. Prej llojeve halorë më të njohurat janë: Bredhi, Hermoqi, Aeneni, Rrobulli dhe kulturat pyjore të Pishës së Zezë. Pyjet e gështenjës, dushkut dhe shkozës, janë pyje kryesisht në pronësi private dhe

janë të shtrira në sipërfaqe prej rreth 1% të sipërfaqes së përgjithshme. Verri, Plepi i Egër, Panja, Mështekna etj. shtrihen kryesisht në pronësi publike dhe në sipërfaqe të vogla.

Për të gjitha llojet ekzistojnë kushte optimale për rritje të drurëve të një kualiteti të lartë. Rritje vjetore e masës drurore në gjithë sipërfaqen pyjore është ~5.07 m³/Ha. Potenciali i zhvillimit të pylltarisë në Junik në favor të zhvillimit të industrisë së drurit dhe përpunimit final ende nuk është hulumtuar. Aktualisht ato shfrytëzohen për prodhimin e drurit për djegie, meqë, tregu dhe organizimi i mirëfilltë mungon, një sasi e konsiderueshme nga pyjet e ahut shfrytëzohet për nevoja të industrisë së drurit. Rritja (shtimi) mesatar vjetor i vëllimit të masës drunore është llogaritur të jetë rreth 5.07 m³/ha.

Tabela 7. Kategoritë e pyjeve në Komunën Junik

Nr	Llojet pyjore	Sipërfaqja (ha)	Vëllimi (m ³)
1	Pyll i larte shumë moshor	2423	607,393
2	Pyll i degraduar	333	62,347
3	Pyll i larte njëmoshor	97	21,093
4	Pyll cungishte	360	51,633
5	Shkurre	0	0
6	Sipërfaqe joproductive	231	
Totali		3,444	742,466

Burimi: Komuna Junik 2024

Nga ana tjetër vështirësitë në zhvillimin e këtij sektori, shihen edhe tek kompetencat në menaxhim të pyjeve për faktin e shpalljes së Parkut Nacional Bjeshkët e Nemura, i cili jep në kompetencë menaxhimin në pjesën më të madhe të pyjeve të Komunës së Junikut, Agjensionit për Menaxhimin e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemura. Transferimi i kompetencave për mbrojtjen e pyjeve dhe shfrytëzimin jep mundësi për të krijuar një situatë të re sidomos në pyjet në pronësi publike. Është më se e nevojshme që rolet dhe përgjegjësitë për të gjitha palët e përfshira të sqarohen dhe kuptohen sepse menaxhimi i pyjeve ka nevojë për të adresuar si potencialin e zonës po ashtu

edhe nevojat e komunitetit për produktet pyjore dhe shërbimet për një menaxhim të qëndrueshëm. Modeli aktual i menaxhimit të pyjeve për t'u aplikuar në këtë situatë të re me kompetencat e decentralizuara për pyjet akoma nuk është i sqaruar. Ngritja e kapaciteteve Komunale për menaxhim pyjesh është esenciale.

Sektori i pyjeve private është i organizuar dobët dhe me institucionalizim të kufizuar që shpie tek një sektor i pylltarisë që nuk siguron kuadër dhe shërbime të nevojshme optimale për sektorin privat. Shumica e pyjeve kanë menaxhim të paqëndrueshëm dhe prerjet ilegale mbesin problem serioz.

Në sektorin privat të pyjeve kjo ndodh për shkak që korniza ligjore e sektorit privat dhe e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve nuk është e rregulluar plotësisht. Ekziston një nivel i ulët i përfshirjes së aktorëve vendor, siç janë komunat dhe komunitetet në sektorin e pylltarisë duke rezultuar në rregullim të limituar të menaxhimit të pyjeve lidhur me nevojat e këtyre aktorëve dhe duke i kufizuar mundësitë për zhvillim ekonomik. Hapat e parë në zhvillimin e pylltarisë private janë hedhur me themelimin e Shoqatës së Pronarëve të Pyjeve me përkrahjen e projektit të SNV –SIDA, për forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Zhvillimi i sektorit privat dhe decentralizimi i pyjeve i jep një mundësi të mirë zhvillimit ekonomik rural. Sidomos në zonat e largëta, sektori i pylltarisë është një ndër sektorët që siguron të ardhura dhe mundësi punësimi. Aktualisht, për shkak të kushteve të kufizuara, pyjet nuk përdoren dhe nuk menaxhohen në mënyrë të duhur (ka degradim dhe shërrim resursesh pyjore). Kushtet e duhura (institucionale, sociale dhe ekonomike) mund ta ndryshojnë këtë, ku pyjet private dhe të decentralizuara janë duke kontribuar në ekonominë rurale dhe duke i ruajtur shërbimet pyjore në dobi të shoqërisë duke kontribuar në mirëqenien sociale dhe ekonomike.

Silvikultura: Silvikultura është pak e zhvilluar në Junik. Në këtë territor funksionojnë disa fidanishte të vogla në sipërfaqe jo më të madhe se 1ha.

3.7.2 Resurset Natyrore dhe Potenciali për Zhvillimin e Turizmit

Aktualisht turizmi nuk është sektor i zhvilluar në këtë komunë edhe pse potenciali natyror dhe ai kulturor ekziston. Potenciali turistik i Komunës së Junikut është ngushtë i lidhur me pozitën gjeografike dhe vlerat kulturore e natyrore të komunës të cilat ofrojnë kushte për zhvillimin e turizmit malor/veror dhe dimëror, turizmit rekreativ dhe atij kulturor.

Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik Komuna e Junikut ndahet në katër zona me

lokalitetet turistike:

- Zona urbane: me potencialin e zhvillimit të turizmit kulturor dhe atij rekreativ;
- Zona e Eko – fshatave: Gropa e Erenikut, Berish, Qershise, Pllaqice, Rrasa e Zogut;
- Zona Gryka e Junikut me lokalitetet turistike: Liqejtë e Gjeravicës, Burimet e Erenikut, Lugu i Gjatë dhe Rrasa e Zogut, si dhe
- Zona e Zharres me lokalitetet: Gradina, Jedova, Zharra, Jasiq dhe Gjocaj (shih më gjerësisht kaptinën e potencialit natyror).

Aktualisht komplekset/zonat më të vizituara nga turistët janë: Maja e Gjeravicës me dy liqejtë natyror; lumi Erenik, Moronica, Kullat, etj.

Sektori i turizmit është ngushtë i lidhur me zhvillimin e hotelierisë dhe gastronomisë (kuzhinës). Hotelet dhe ndërtesat që ofrojnë shërbime hoteliere në Junik janë një numër i konsiderueshëm të cilat menaxhohen nga sektori privat. Kapaciteti i këtyre ndërtesave hoteliere është i kënaqshëm. Meqë turizmit i është dhënë prioritet si sektor i zhvillimit në të ardhmen, atëherë duhet marrë parasysh edhe ngritja e kapaciteteve hoteliere. Përveç hotelierisë, faktorë tjerë të cilët gjithashtu ndikojnë në zhvillimin e turizmit janë: qasja (arritshmëria) deri te objektet/lokacionet turistike; konkurrenca; promovimi (marketingu); aktivitetet (ngjarjet kulturore, sportive, argëtuese etj.) etj. Këto elemente mungojnë shumë në Junik ndaj ka nevojë për veprime të menjëhershme në këto fusha.

Industria dhe Prodhimtaria

Në komunën e Junikut industria nuk është e zhvilluar. Ekzistojnë disa kompani të cilat merren me përpunimin e asfaltit dhe zhavorrit, si dhe së fundmi fabrika për përpunimin e ujit. Punësimi në këtë kompani bëhet në bazë të nevojave dhe është kryesisht sezonal. Siç u përmend më lartë potenciali për zhvillimin e industrisë së drurit ende nuk është hulumtuar. Nga ana tjetër nëse rritet fondi i blegtorisë ka mundësi për zhvillimin e industrisë së mishit në të ardhmen.


Zejtaria dhe artizanatet

Traditat e junikasve njihen në kultivimin e zejeve si për përpunimin e leshit, thurjes së rrobave tradicionale, qëndisjes, etj. Me qëllim të ruajtjes së traditave por edhe përfitimit, shërbimeve dhe kultivimit të produkteve të zejtarisë duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Zhvillimi i tij duhet të shihet i ndërlidhur me zhvillimin e turizmit.

Tregtia dhe Bizneset

Sektori i tregtisë është pak i zhvilluar përkundër faktit që pas luftës së vitit 1999, në Junik ka pasur një rritje të regjistrimit të bizneseve private. Aktualisht në Junik gjithsej janë të evidentuara 121 biznese që ushtrojnë veprimtaritë e tyre. Shumica nga këto, janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të paregjistruara janë 18. Prej tyre shumica e ndërmarrjeve janë biznese familjare kryesisht si ndërmarrje tregtare dhe me gjithsej 140 të punësuar në sektorin privat. Komuna e Junikut ka përgatitur edhe Strategjinë për Zhvillim Lokal e cila i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit dhe përkrahjes së biznesit.

Grafiku 2. Llojet e veprimtarive në Junik



Burimi: Komuna Junik 2024

Shërbimet financiare: Këto shërbime në Junik kryhen përmes filialit të bankave. Ekzistojnë edhe kompani transfertash monetare dhe institucione financiare, që ofrojnë pagesat dhe transfertat, të cilat ofrojnë kredi në sektorin e bujqësisë, blegtorisë. Këto institucione i ofrojnë sektorit privat kredi dhe këshilla për kredi. Megjithatë, niveli i lartë i interesit për kredi nuk i favorizon banorët apo zhvillimin e biznesit.

3.8 Mjedisi, Burimet Natyrore, Burimet Ujore dhe Zonat e Mbrojtura

Në këtë kapitull do të zhvillohet një analizë e përgjithshme mjedisore dhe e aspekteve të cilat impaktojnë mjedisin në nivel lokal. Komuna e Junikut ka një mjedis relativisht të pastër, me mungesë të aktiviteteve industriale ndotëse. Ndotja është në nivele të ulëta dhe nuk ka aktivitete të rëndësishme që dëmtojnë mjedisin lokal.

Përbërja e tokës: Komuna e Junikut ka një sipërfaqe totale prej 7,769.93 ha, prej të cilave rreth 4,439 ha (57.08%) janë tokë bujqësore. Livadhet dhe kullotat zënë rreth 2,000 ha, ndërsa pyjet mbulojnë 3,029 ha që paraqesin potencial për zhvillim. Në zonën urbane të Junikut dominon tokë relativisht e thellë e përshtatshme për prodhime bujqësore, ndërsa, në pjesët e tjera, dominon tokë e cekët e përshtatshme për kullosa dhe zhvillim të pylltarisë.

Peisazhet, resurset natyrore dhe biodiversiteti: Pozita gjeografike dhe relievi i zonës ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit natyror. Peisazhet hidrografike, Lumi Erenik dhe Lumi i Qetë, si dhe malet dhe grykat, janë vlera të rëndësishme për promovimin e biodiversitetit dhe turizmit ekologjik. Vlera e Moronicës si zonë e veçantë ofron mundësi zhvillimi për turizëm tradicional dhe gastronomik.

Bjeshkët e Junikut, të cilat janë pjesë përbërëse e Alpeve Shqiptare (duke iu referuar raportit të MMPH mbi gjendjen në natyrë, Bjeshkët e Nemuna janë propozuar

për mbrojtje në nivel kombëtar). Në vitin 2013 ka hyrë në fuqi LIGJI NR. 04/L - 086 "Për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", që mbulon një sipërfaqe prej 62,488 ha. Ky park, i administruar nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar, është një hapësirë natyrore e mbrojtur me rëndësi të lartë ekologjike.

Biodiversiteti Zona është e pasur me lloje të rrezikuara dhe endemike, përfshirë Draba Karabensis dhe Cerastium Dinaricum, të përfshira në listat ndërkombëtare të mbrojtura. Pasuritë natyrore kërkojnë mbrojtje dhe masa të forta për ruajtjen e biodiversitetit.

Katastrofat Natyrore dhe Rreziku nga Erozioni dhe Vërshimet: Dukuri të tilla si erozioni dhe vërshimet janë shqetësime të rëndësishme. Lumi Erenik është një zonë e rrezikuar nga vërshimet, sidomos gjatë periudhave të reshjeve të mëdha. Kjo kërkon mbrojtje dhe menaxhim të kujdesshëm të shtratit të lumit për të parandaluar dëmtimet. Masat për parandalimin e erozionit dhe vërshimeve duhet të përfshijnë ndalimin e prerjes së pyjeve dhe mbjelljen e drurëve të rinj.

Prerja e pyjeve të Junikut është prezente sidomos e shprehur tek pyjet në sektorin publik (në lokacionet Stanishtë e Goqit, Zharrë, Gradinë). Pasojat nga kjo, përveç humbjes së masës drurore, paraqiten edhe në çrregullimin e ekosistemit, prishjen e peisazhit, paraqitjen e erozionit në këto zona etj.

Ndryshimet klimatike: Gjatë dy dekadave të fundit janë vërejtur ndryshime të ndjeshme në kushtet klimatike, si rritja e temperaturave, pakësimi i reshjeve, periudha të zgjatura thatësire si edhe përmbytje të herëpashershme. Të gjitha këto përbëjnë tregues të qartë të përshpejtimit të ndryshimeve klimatike.

Edhe pse mungojnë studime dhe analiza të thelluara mbi këtë problematikë, efektet e ndryshimeve klimatike janë tashmë të

dukshme në Komunën e Junikut. Veprimtaritë e përditshme të banorëve të Komunës së Junikut kanë ndikim në përmirësimin apo përkeqësimin e gjendjes mjedisore. Shfrytëzimi i veturave, prerja e drunjve për ngrohje pa një ritëm të mjaftueshëm mbjelljeje, janë disa prej shkaktarëve që ndikojnë në rritjen e emetimeve të gazeve të efektit serrë. Arsyeja kryesore e përdorimit të një sasive të lartë të drurit për ngrohje është mungesa e sistemit qendror të ngrohjes në Junik.

Furnizimi i dobët me energji elektrike në Junik dhe rrjeti i vjetër elektrik, është një arsye tjetër që ndikon në sasinë e drurit të përdorur për ngrohje dhe rritjen e emetimeve të gazeve të efektit serrë, pasi banorët përballen me ndërprerje të energjisë elektrike dhe që rezulton në shfrytëzimin e gjeneratorëve me diesel dhe drunjve për ngrohje.

Ndër dukuritë më të shpeshta dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në klimë, por edhe të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, janë zjarret. Duke qenë se Juniku është një zonë me sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, kjo dukuri përbën një problematikë të dyfishtë: nga njëra anë, kërcënon pyjet që shërbejnë si absorbues natyralë të CO₂, dhe nga ana tjetër, çliron sasi të mëdha të CO₂ gjatë procesit të djegies.

Në këtë kontekst, një masë prioritare do të ishte forcimi i sistemit të monitorimit të pyjeve dhe ngritja e një sistemi efektiv të paralajmërimit të hershëm për zjarret në zonat pyjore. Gjithashtu, është thelbësor rigjenerimi i pyjeve, me qëllim maksimizimin e kapacitetit të tyre për të thithur CO₂.


Përveç kësaj, është e domosdoshme zbatimi i masave zbutëse për të minimizuar erozionin dhe përmbytjet lumore, të cilat përbëjnë rrezik serioz për sektorin bujqësor. Njëkohësisht, duhet të ndërmerren hapa për përballimin e thatësirave të shpeshta, të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta ekonomike, veçanërisht në bujqësi dhe blegtori.

3.9 Analiza e kapaciteteve institucionale

Komuna përfaqëson një strukturë të konsoliduar institucionale, e cila mbështetet në një organizim funksional që përfshin Këshillin e Drejtorëve, shtatë drejtori dhe tetëmbëdhjetë sektorë. Këshilli i Drejtorëve, i përbërë nga drejtuesit e emëruar nga Kryetari i Komunës, luan një rol thelbësor në

zbatimin e vendimeve dhe në koordinimin ndërinstitutional. Drejtoritë dhe sektorët përkatës kanë përgjegjësi të qarta dhe përmbushin funksione që ndërlidhen me zhvillimin lokal, shërbimet publike, planifikimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet ekonomike e sociale.

Figura 6. Organigrama e Komunës Junik



Burimi: Komuna Junik 2024

Në kontekstin e menaxhimit të efijencës së energjisë dhe zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike, disa nga strukturat ekzistuese kanë rol të drejtpërdrejtë. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, në bashkëpunim me Sektorin për Mjedis, ka potencialin të udhëheqë përpjekjet për integrimin e masave për kursimin e energjisë në planifikimin hapësinor dhe ndërtimet publike. Po ashtu, Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim, së bashku me sektorët përkatës, luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e masave teknike. Një tjetër aktor kyç është Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, që përmes sektorëve të saj mund të kontribuojë në integrimin e objektivave të energjisë së pastër dhe qëndrueshmërisë në planet zhvillimore.

Nga analiza e strukturës aktuale të administratës komunale dhe funksioneve të drejtorive, vihet re se pozicioni i Koordinatorit për Efijencën e Energjisë në nivel vendor mungon. Ky është një boshllëk në strukturën institucionale, duke pasur parasysh sfidat dhe përgjegjësitë në rritje për menaxhimin e energjisë dhe zbatimin e politikave për qëndrueshmëri mjedisore.

Një zgjidhje e përshtatshme do të ishte krijimi i një pozicioni të ri punësimi për Koordinatorin për Efijencën e Energjisë në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastrën dhe Mjedisin. Kjo drejtori është natyrshëm e

lidhur me proceset e planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave publike dhe private – fusha të cilat janë thelbësore për zbatimin e masave të efijencës energjetike. Për më tepër, kjo drejtori mbulon edhe aspekte që lidhen me përdorimin e materialeve ndërtimore dhe implementimin e teknologjive të gjelbra, siç janë panelet fotovoltaike, të cilat kërkojnë koordinim teknik dhe planifikim të integruar në territor.

Pozicioni i koordinatorit do të shërbente si një pikë kyçe për orientimin dhe zhvillimin e politikave lokale për efijencën e energjisë dhe klimën, duke mbledhur dhe analizuar të dhënat për zbatimin e masave përkatëse, si dhe duke monitoruar progresin e Planit Komunal të Veprimit për Energjinë dhe Klimën. Përveç kësaj, ky rol do të siguronte bashkëpunim ndërdrejtorish, veçanërisht me Drejtorinë për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim, për të nxitur masa të efijencës energjetike në ndriçimin publik, sistemet e ngrohjes, transportin dhe infrastrukturën komunale në përgjithësi.

Krijimi i këtij pozicioni do të përmirësonte ndjeshëm kapacitetin institucional të komunës për të adresuar sfidat energjetike dhe klimaterike, si dhe për të siguruar një qasje të koordinuar, të qëndrueshme dhe të matshme në menaxhimin e burimeve energjetike në nivel lokal.

4. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE TË GRUMBULLUARA DHE TREGUESIT NË NIVEL KOMUNE

Për hartimin dhe zbatimin e politikave për efijencën e energjisë dhe klimën, një komponent themelor është grumbullimi i të dhënave të sakta dhe të besueshme. Këto të dhënashërbejnë si bazë për analizën e situatës aktuale, vlerësimin e nevojave, përcaktimin e objektivave realiste dhe monitorimin e progresit. Treguesit e përzgjedhur ndihmojnë në matjen e performancës së ndërhyrjeve dhe lejojnë krahasime ndërmjet

periudhave kohore ose zonave të ndryshme. Krijimi i një strukture të qëndrueshme për mbledhjen dhe përditësimin e këtyre të dhënave është i domosdoshëm për të garantuar vendimmarrje të informuar dhe për të siguruar transparencë në procesin e tranzicionit energjetik në nivel lokal.

Në këtë kapitull jepen informacione të detajuara mbi konsumin energjetik sipas

burimit dhe llojeve të ndërtesave nga vjen ky konsum. Ndër më kryesoret mund të përmendim: Ndërtesat Publike, Transporti dhe Ndriçimi Publik, këto janë dhe fokusi kryesor i përmirësimit nga masat e parashikuara në Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë.

Procesi i grumbullimit të të dhënave nga komuna përfshin të dhënat mbi konsumin e energjisë nga sektori publik dhe privat, duke e ndarë sipas llojeve të shërbimeve që ofrohen nga administrata vendore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar konsumit të energjisë në sektorët rezidencial, tregtar dhe bujqësor, si dhe konsumit të automjeteve që janë në funksion të shërbimeve publike. Kur është e mundur, është marrë parasysh edhe konsumi i automjeteve private. Një element i rëndësishëm është edhe konsumi i energjisë nga ndriçimi publik, i cili përbën një nga shërbimet me ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e përgjithshëm të konsumit energjetik në territorin e komunës.

Tabela 8. Konsumi i energjisë sipas llojit

Sektori	Viti 2023	
	Konsumi i energjise (kWh/vit)	
Publik	1,084,833.49	12.2%
Privat	7,780,339.61	87.8%
Totali	8,865,173.10	100.0%

Burimi: Komuna Junik 2024

Sipas të dhënave të konsumit energjetik nga Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë (KEDS) dhe nga llogaritjet e komunës konsumi total vjetor i Komunës së Junikut përllogaritet në rreth 8.86 GWh ose 0.14% e konsumit energjitik në nivel kombëtar të Republikës së Kosovës që në vlera absolute perlllogaritet në 6,291 GWh për vitin 2023. Sektori Publik përbën 12.2 % të konsumit energjitik lokal ndërkohë konsumi i sektorit privat përbën 87.8% të konsumit.

Sa i përket konsumit të energjisë në sektorin publik, sipas llojit të shërbimit, ky sektor

Metodologjia e përdorur për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave është bazuar në kombinimin e statistikave të brendshme komunale, institucioneve të tjera përkatëse që administrojnë të dhëna mbi konsumin, intervistave me përfaqësues të sektorëve përgjegjës dhe mbështetjes teknike nga aktorë të jashtëm, kur ka qenë e nevojshme. Ato janë kategorizuar sipas sektorëve për të mundësuar krahasime dhe identifikimin e prioriteteve. Gjithashtu, është përdorur qasja historike për të analizuar prirjet e konsumit ndër vite dhe për të vlerësuar potencialin për kursime në të ardhmen. Ky proces ka qenë thelbësor për hartimin e masave konkrete në kuadër të Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë.

Të dhënat përmbledhëse për sektorin publik dhe privat në nivel komunal ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi konsumin e energjisë dhe nivelin e emetimeve të CO₂.

përbëhet nga ndërtesat e administratës vendore, institucionet arsimore, ndërtesat shëndetësore si dhe ato të kulturës dhe sportit. Sipërfaqen më të madhe të ndërtuar e zënë ndërtesat arsimore, të cilat përfaqësohen nga 4 ndërtesa me një sipërfaqe totale prej 20,206 m². Në përputhje me këtë, sektori i arsimit ka edhe përqindjen më të lartë të konsumit të energjisë në sektorin publik, me 76.9% të totalit. Pas tij vijnë sektori shëndetësor me 12.79% dhe administrata vendore me 10.29% të konsumit të përgjithshëm energjetik në këtë sektor.

Tabela 9. Konsumi i energjisë në vitin 2023 për ndërtesat publike

Sektori		Viti 2023		
		Sipërfaqe m ²	Konsumi i energjisë (kWh/vit)	
Ndërtesat e shërbimeve publike	Administrative	5,132	93,153	10.29%
	Arsimore	20,206	696,000	76.92%
	Shëndetësore	2,020	115,732	12.79%
	Kulturore/Sportive	0	0	0.00%
Totali		27,358	904,885.6	100.00%

Burimi: Komuna Junik 2024

Tabela 10. Konsumi i energjisë në vitin 2023 për ndërtesat e banimit

Sektori	Viti 2023	
	Numri i abonenteve	Konsumi i energjise (kWh/vit)
Banim (Rezidencial)	1,288	6,310,565.27
Ekonomi Komercale	182	1,408,310.34

Burimi: Komuna Junik 2024

Konsumi i energjisë në sektorin privat përbëhet nga konsumi i ndërtesave rezidenciale dhe i ndërtesave tregtare. Sasia totale e konsumit të energjisë në sektorin privat përlogaritet 7.71 GWh ku rreth 81.7% vijnë nga konsumi i ndërtimeve rezidenciale

dhe 18.3% nga konsumi energjitik i ndërtesave komerciale. Në Komunën Junik në total kemi rreth 1,470 ndërtime në përdorim nga të cilat 87% e përbëjnë ndërtimet me funksion rezidencial dhe 13 % ndërtimet me funksion komercial.

Tabela 11. Konsumi i energjisë në vitin 2023 për automjetet në disponim të Komunës Junik

Institucioni	Numri i makinave	Litra/Naftë në vit	Energjia eq kWh
Administrata komunale	10	15,024	150,242
QKMF	2	1,400	14,000
Qendra Sociale	1	600	6,000
Zjarrfikësit	2	690	6,900
Transporti i nxënësve autobuz	1	3,700	37,000
Eko Regjioni	1	4,230	42,308
Totali	17	25,645	256,450

Burimi: Komuna Junik 2024

Konsumi i energjisë nga automjetet dhe emetimi i gazrave të efektit serre, nga keto janë një ndër problematikat më të mëdha në nivel global. Në analizën e detajuar në këtë sektor Komuna Junik ka në përdorim

10 automjete, ndërsa rreth 7 automjete të tjera i kanë institucionet në varësi. Në total total kemi rreth 17 automjete dhe 256,450 kWh energji të konsumuar në vitin 2023. Nga tabela e mëposhtme sa i përket vjetërsisë së

flotës së makinave vetëm 3 nga 10 makinat janë më të reja se 10 vite prodhim. Gjë që shton nevojën për flotë të re automjeteve më

impakt të reduktuar në mjedis dhe efijencë të lartë përdorimi.

Tabela 12. Specifikimet e flotës së automjeteve Komuna Junik

Nr	Lloji i automjetit	Viti i prodhimit	Kapaciteti në cm³	Lloji i karburantit
1	HYUNDAI TLE TUCXON ix35	2020	1995	Dizel
2	HYUNDAI CARDI	2009	1582	Dizel
3	HYUNDAI IX 35 CARDI - Jashtë përdorimit	2010	1995	Dizel
4	TOYOTA 4 RUNNER	1999	2982	Dizel
5	TOYOTA PRADO	2004	2982	Dizel
6	TOYOTA 4 RUNNER	1999	2982	Dizel
7	RENAULT CLIO	2023	1461	Dizel
8	NISAN PATHFINDER SE 2.5TDI M/T	2008	2488	Dizel
9	PEUGEOT NEW PARTENER, CREW CAB – QKMF	2023	1499	Dizel
10	CITROEN Y – QKMF	2016	2198	Dizel

Burimi: Komuna Junik 2024

Në tabelën e mëposhtme jepet konsumi i energjisë për sa i takon ndriçimit publik si një

nga konsumatorët më të rëndësishëm, duke përfshirë elementet përbërës të tij.

Tabela 13. Specifikimet e rrjetit të ndriçimit publik

Sektori	Viti 2023				
	Konsumi i energjisë (kWh/vit)	Sipërfaqja në metër katror e hapsirave publike të ndriçuara	Gjatësia në metër linear të rrugëve të ndriçuara	Numri i llambave LED	Numri i llambave total
Ndriçimi publik, Rrugë sheshe dhe parqe	72,947.03	97,806	55,000	1,300	1,300
Totali	72,947.03	97,806	55,000	1,300	1,300

Burimi: Komuna Junik 2024

Sistemi i ndriçimit urban në Komunën Junik është i përbërë prej rreth 55 km linear i cili paraqitet ne cilësi të mirë dhe shërben për ndriçimin e hapsirave publike në qytezën e Junikut. Ky rrjet përbehet nga rreth 1,300 llamba LED të cilat janë llamba që sigurojnë efijencë energjitike me një konsum rreth 72,947 MWh në vit. Nga informacioni në

komunë sa i përket cilësisë së këtij rrjeti specialistët shprehen se ka cilësi të mirë të rrjetit duke qënë që ky rrjet mirëmbahet dhe është pjesërisht i ri ku janë kryer investime të konsiderueshme në të. Po ashtu parashikohen investime të reja në këtë zonë kryesisht në hapsirat publike përgjatë lumit të Erenikut.

5. PROJEKTE DHE SHEMBUJ TË ZBATIMIT TË PARIMEVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË TERRITOR

Në kuadër të projekteve dhe shembujve të zbatimit të parimeve të efiçencës së energjisë në territor, është e rëndësishme të theksohet se implementimi i këtyre parimeve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet lokale. Projekte të ndryshme, si ato që përfshijnë instalimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme, janë ndër shembujt më të spikatur të zbatimit të këtyre parimeve. Një shembull i tillë është instalimi i paneleve fotovoltaike në ndërtesa publike, siç janë ndërtesa e Komunës, Qendra e Kujdesit Mjekësor, dhe gjimnazi i qytetit, të cilat janë financuar nga donatorë të ndryshëm, përfshirë KFOR dhe Caritas Zvicra. Këto investime kanë si qëllim uljen e konsumit të energjisë nga burimet tradicionale dhe ndihmojnë në zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis.

Përveç energjisë fotovoltaike, projekte të tjera përfshijnë përdorimin e energjisë së rinovueshme për ngrohje dhe ftohje të ndërtesave, instalimin e sistemeve të menaxhimit të energjisë, dhe përmirësimin

e infrastrukturës termike të ndërtesave për të minimizuar humbjet e energjisë. Për të mbështetur këto projekte, është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse, që përfshin edukimin dhe trajnimin e individëve dhe organizatave për praktikën më të mirë të përdorimit të energjisë dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

Një tjetër shembull i rëndësishëm është zhvillimi i politikave dhe ligjeve që mbështesin përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe efiçencës së energjisë, duke ofruar stimuj për investimet në këtë fushë. Këto masa ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e projekteve të ngjashme, duke kontribuar në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe uljen e ndotjes. Në këtë kuadër, është thelbësore të zhvillohen iniciativa që angazhojnë komunitetin lokal në proceset e vendimmarrjes dhe realizimit të këtyre projekteve, për të siguruar që ato janë të përshtatshme dhe efikase për nevojat lokale dhe të kenë ndikim pozitiv në cilësinë e jetës dhe zhvillimin ekonomik të territorit.

Tabela 14. Projektet të cilat lidhen e efiçencën e energjisë në Komunën e Junikut

Emri i projektit	Burimi Financiar	Viti	Vlera e investimit (Euro)	Komente
Panelat Solar Ndërtesa e Komunës së Junikut Fuqia: 10 kWp	Donacion nga KFOR	2022	13,000	-
Panelat Solar Ndërtesa e QKMF Fuqia: 15 kWp	Donacion nga KFOR	2024	20,000	-
Panelat Solar Gjimnazi "Kuvendi i Junikut" Fuqia: 4.5 kWp	Donacion nga Caritas Zvicerian	2023	4,100	Jashtë funksioni

Burimi: Komuna Junik 2024

Në tabelën e mësipërme janë listuar iniciativat e zhvilluara në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të energjisë, ku përfshihen tre projekte kryesore. Dy prej tyre janë financuar nga donacionet e KFOR për instalimin e paneleve fotovoltaike: një në ndërtesën e Komunës me fuqi të

instaluar 10 kWp dhe një tjetër në QKMF me fuqi të instaluar 15 kWp. Po ashtu, një tjetër projekt është realizuar në Gjimnazin “Kuvendi i Junikut”, ku janë instaluar panele fotovoltaike me fuqi të instaluar 4.5 kWp, me financim nga Caritas Zvicra.

6. PRODHIMI DHE RRJETI I SHPËRDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NË NJQV

6.1 Struktura e Rrjetit Energjetik dhe Infrastruktura e Shpërndarjes së Energjisë.

Rrjeti i furnizimit me energji elektrike në Komunën e Junikut është relativisht i dobët dhe i vjetëruar. Shërbimi i furnizimit me energji elektrike kryhet nga Korporata Elektroenergjitike e Kosovës (KEK)Keds. Sipas një informacioni të marrë nga KEK, Divizioni i Rrjetit, Distrikti Pejë, dalja 10 kV e Junikut për momentin furnizohet nga linja TS 100/10 kV që vjen nga Lluka e Epërme në Deçan e cila furnizon qytezën e Junikut,

Gjocajt dhe Jasiqin. Në aspektin energjetik kjo dalje 10 kV bën pjesë në daljet më të mbi ngarkuara dhe gjendja teknike e saj është e paqëndrueshme. Si rrjedhojë e kësaj në plan është projekti për shkarkimin e kësaj daljeje. Komuna e Junikut furnizohet me energji elektrike nga 28 kabina elektrike të cila më pas përçojnë energjinë në rrjetin shpërndarës me tension të ulët.

Tabela 15. Nënstacionet elektrike të furnizimit me energji në Komunën e Junikut

Distrikti	Kodi i TS 10/04 kV	Njehsori	Emri i TS 110/35/10kV	Emri i Feeder	Emri i TS 10/04 kV
DPE	53000007017	35779148	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Oda e Junikut
DPE	53000007018	35715462	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Lagja 2
DPE	53000007019	50882151	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Lagja 1
DPE	53000007020	35778667	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Gaxherhtë
DPE	53000007021	35778679	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Miroctë
DPE	53000007022	87823775	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Gurëthyesi
DPE	53000007023	35719634	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junikë Qendra
DPE	53000007024	35779129	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junikë Vorret
DPE	53000007025	51284932	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junikë Shkolla
DPE	53000007026	35719594	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junikë Gacaferhtë

Distrikti	Kodi I TS 10/04 kV	Njehsori	Emri I TS 110/35/10kV	Emri i Feeder	Emri I TS 10/04 kV
DPE	53000007027	35719614	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Berishtë
DPE	53000007028	35719804	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Neziri (Osmonaj)
DPE	53000007029	35719595	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Qestaj
DPE	53000007030	35715637	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Gjocaj
DPE	53000007039	35719710	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Jasiqi
DPE	53000007040	96256517	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Goqtë
DPE	53000007041	73756361	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Ujrat e Zeza Junik
DPE	53000007045	35719502	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Gjimnazi
DPE	53000007046	44447422	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Fenix A Junik
DPE	53000007047	73756149	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik - Krasniqë
DPE	53000007050	75521510	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Teqja e madhe Sheh Xhaferi
DPE	53000007052	35721403	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Shafrane
DPE	53000007053	35715547	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	Junik Laxha Berisha
DPE	53000007056	96256546	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	TS.GACAFERI E REJA
DPE	53000007057	96257337	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	TS - ARASHA
DPE	53000007058	40239932	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	"Juniku" SHPK Hasan Lushi
DPE	53000007059	35721395	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	TS - FLUX SHPK
DPE	53000007061	51285044	TS 110/10kV Deçani	J22 Juniku	TS "KAM GROUP" SH.P.K.

Burimi: Komuna Junik dhe KEDS 2024

Infrastruktura e rrjetit elektrik të nivelit të TU 0.4 kV është relativisht në gjendje jo të mirë teknike duke përfshirë edhe vetë qendrën e Junikut. Pjesa më e madhe është linjë ajrore me shtylla të betonit dhe të drurit shumë të vjetruara sikurse edhe kabinat elektrike të mbingarkuara të cilat nuk plotësojnë kërkesat e konsumatorëve. Situata me furnizim do të përmirësohet me përmirësimin e rrjetit dhe kabinave ekzistuese si dhe ndërtimin e TS-ve

kabinave të reja në lagjen Qok. Meqenëse ky lokalitet është në rritje dhe në ndërtim e sipër është e nevojshme që këto rrjete elektrike ekzistuese të zëvendësohen me rrjete të reja kabllore nëntokësore me një infrastrukturë të harmonizuar sipas standardeve më të reja për të evituar rreziqet e mundshme dhe ofruar furnizim kualitativ. Nëse në të ardhmen e afërt do të realizoheshin edhe projektet e ndërtimit të hidrocentraleve

kjo do të ndikonte në furnizim më të mirë me energji, krijonte lehtësi në ngarkesën e rrjetit, si dhe kursim të energjisë.

Në rrjetin e radio televizionit dhe internetit operojnë dhe funksionojnë disa operatore si: PTK, IPKO, KUJTESA dhe TELKOS. Rrjeti 3G dhe 4G funksionon në pjesën më të madhe të komunës së Junikut. Nga të dhënat e PTK

dhe Ipko, aktualisht në komunën e Junikut ka 420 kycje në rrjetin e telefonisë dhe internetit. Duke marrë parasysh aspiratat për zhvillimin e turizmit, padyshim që teknologjia informative dhe krijimi i një shoqërie informative ka rëndësi të madhe, ndaj investimet në zgjerimin e shtrirjes së rrjetit të telekomunikimit janë të nevojshme.

7. VLERËSIMI I KONSUMIT TË ENERGISË

Analiza e konsumit të energjisë në territorin e Komunës së Junikut përfshin të gjithë aktorët që kontribuojnë në kërkesën për energji, duke përfshirë sektorin publik, sektorin privat dhe infrastrukturën ndihmëse. Konsumi i energjisë lidhet ngushtë me përdorimin funksional të ndërtesave, nivelin e amortizimit të tyre dhe gjendjen fizike aktuale, veçanërisht në ndërtesat publike dhe shërbimet që ushtrohen nga pushteti vendor, të cilat janë ndër konsumatorët më të mëdhenj.

Vlerësimi përfshin gjithashtu ndarjen e konsumit sipas burimeve të energjisë, duke identifikuar se në çfarë mase përdoren energjia elektrike, druri, nafta, peleti apo burime të tjera, në varësi të funksionit të objekteve dhe sektorëve përkatës. Kjo analizë synon të përcaktojë zonat me potencial për ndërhyrje dhe të mbështesë zhvillimin e masave për rritjen e efijencës energjetike dhe dekarbonizimin.

7.1 Analiza Energjetike e Shërbimeve Publike

Në vijim të analizës së përgjithshme të efijencës energjetike në nivel lokal, ky nënkapitull thellohet në shqyrtimin e detajuar të burimeve energjetike që mbështesin konsumin total dhe mënyrës se si ky konsum shpërndahet midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike. Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu gjendjes aktuale fizike të infrastrukturës së këtyre shërbimeve, duke ofruar një kuadër të plotë për të kuptuar jo vetëm origjinën dhe sasinë e energjisë së përdorur, por edhe implikimet e saj në emetimet e dioksidit të karbonit dhe potencialin për përmirësime të ardhshme. Ky ekzaminim i hollësishëm shërben si themel i rëndësishëm për identifikimin e prioriteteve dhe hartimin e strategjive efektive në fushën e efijencës energjetike.

Tabela 16. Llojet e konsumit të energjisë së konsumuar, sasia dhe vlera energjetike

Lloji i energjisë dhe njësia	Sasia ne vit	Vlera energjetike (kWh)	Pjesmarrja ne total
Energjia elektrike (kWh)	7,912,3340	7,912,340	87.85%
Karburant për transport-Dizel (Litra)	25,645	256,450	2.85 %
Karburant për transport Benzinë (litra)	0	0	0.00%
Lëndë djegësie drusore (m3)	0	0	0.00%
Lëndë djegëse pellet (kg)	146,000	708,100	7.86%
Lëndë djegëse naftë (litra)	13,000	130,000	1.44%
Totali		9,006,890	100.00%

Burimi: Komuna Junik 2024

Në tabelën e mësipërme përlllogaritet sasia e konsumit të energjisë sipas burimit të saj dhe në nivel vendor. Konsumi i përgjithshëm i energjisë vlerësohet me rreth 9.006 GWh për vitin 2023, rreth 88% e këtij konsumi i përket energjisë elektrike, më pas radhitet energjia që ka si burim lëndën djegëse pellet e cila përdoret për ngrohje me 7.9% dhe energjia e çliruar nga karburanti i

makina ve që përdoren nga entet publike e cila vlersohet me 2.9% të konsumit total të energjisë. Konsumi i energjisë për transport nga benzina për automjetet nga entet publike dhe konsumi i energjisë për ngrohje nga drutë në institucione publike janë zero sepse në komunën Junik nuk figurojnë në inventarin e konsumit energjitik.

Tabela 17. Konsumi i energjisë elektrike dhe termike

Sektori/Nësektori	Sip m ²	Konsumi për energji termike kWh	Konsumi i energjisë elektrike kWh	Konsumi total i energjisë kWh
Ndërtesat publike	27,358	831,100	151,887	982,987
Ndërtesat e administratës	5132	53,000	40,154	93,154
Ndërtesat e arsimit	20,206	708,100	66,000	774,100
Ndërtesat e shëndetësisë	2020	70,000	45,733	115,733
Ndërtesat e kultures dhe sportit	0	0	0	0
Ndërtesat komerciale/ shërbimet private	182	0	1,408,310	1,408,310
Ndërtesat Rezidenciale	1214	0	6,310,565	6,310,565
Total	27,358 m2 dhe 1,396 ndërtesa	831,000	7,870,762	8,701,862

Burimi: Komuna Junik 2024

Konsumi i energjisë ndahet në dy lloje, konsumi i energjisë elektrike dhe konsumi i energjisë termike ku në të shumtën e rasteve energjia elektrike kthehet edhe në energji termike. Zakonisht në Komunën e Junikut në rastin e institucioneve publike energjia termike vjen si rezultat i përdorimit të lëndëve djegëse siç janë nafta ku përdoret kaldaja me naftë ose kaldaja me pellet. Sa i përket konsumit të përgjithshëm energjitik në institucionet publike kjo sasi përlllogaritet në rreth 982,986.54 kWh në vit ku rreth 83% e sasisë së energjisë vjen nga konsumi i lëndëve djegëse që shkojnë për ngrohje ose rreth 831,100 kWh në vit ndërsa energjia elektrike për nevojat të tjera përlllogaritet në rreth 151,886 kWh. Ndërtesat e arsimit janë ato lloj ndërtesash që konsumojnë një sasi të madhe të energjisë termike nga lëndët djegëse që përlllogaritet në rreth 708,100 kWh, ndërsa konsumi i energjisë elektrike është rreth 66,000 kWh ose gati 10% e asaj termike. Nga sektori privat në kuadër të

ndarjes së llojeve të energjive nga burimi nuk disponohen të dhënat, por kemi konsumin total të energjisë nga sektori rezidencial dhe sektori komercial që përlllogariten respektivisht në 6.31 GWh dhe 1.4 GWh.

7.1.1 Ndërtesat Publike

Sa i përket konsumit energjetik në ndërtesat e administratës vendore në këtë ndarje përfshihen 3 ndërtesa: Komuna e Junikut, Zjarrfikësja dhe Qendra Sociale. Ndërtesa me konsumin më të madh të energjisë është Komuna e Junikut, e cili konsumon rreth 87,500 kWh në vit, më pas vazhdon Zjarrfikësja me konsum 13,930 kWh në vit dhe më pas Qendra Sociale me konsum 5,653 kWh në vit.

Në kontekstin e vlerësimit të efijencës energjetike të ndërtesave, konsumi specifik (kWh/m² në vit) shfaqet si një indikator lehtësisht i kuptueshëm. Ky tregues thelbësor

sintetizon sasinë totale të energjisë elektrike të konsumuar nga një ndërtesë brenda një viti dhe e raporton atë në lidhje me sipërfaqen e saj të shfrytëzueshme (të matur në metra katrorë). Duke standardizuar konsumin e energjisë sipas madhësisë së ndërtesës, ky indikator mundëson një krahasim objektiv të performancës energjetike midis ndërtesave të ndryshme, pavarësisht nga dimensionet e tyre absolute.

Një vlerë e ulët e kWh/m² në vit sinjalizon një përdorim efikas të energjisë elektrike, duke nënkuptuar humbje minimale dhe sisteme të optimizuara, ndërsa një vlerë e

lartë nxjerr në pah një intensitet të lartë të konsumit dhe potencialisht, zona ku mund të implementohen masa për përmirësimin e efijencës. Për rrjedhojë, ky indikator shërben si një mjet i domosdoshëm për arkitektët, inxhinierët, menaxherët e ndërtesave dhe politikëbërësit në vlerësimin, monitorimin dhe përmirësimin e performancës energjitike të sektorit të ndërtesave. Nga llogaritjet e kryera për të vlerësuar konsumin specifik për ndërtesat e marra në konsideratë vërehet se konsumi specifik më të larte e ka Qendra Sociale me 37.7 kWh/m² në vit ndërkohë më pas radhitet Komuna e Junikut me 22.9 kWh/m² dhe Zjarrfikësja me me 11.88 kWh/m².

Tabela 18.Konsumi i energjisë total i institucioneve të administrates

Emri i institucionit	Sipërfaqja totale	Konsumi specifik kWh/m2 vit	Konsumi total kWh vit
Komuna e Junikut	3,810	22,966	87,500
Zjarrfikësja	1,172	11,886	13,930
Qendra Sociale	150	37,693	5,653

Burimi: Komuna Junik 2024

Nga ana strukturore, ndërtesa e Zjarrfikëses prezantohet në gjendje mjaft të mirë, duke qenë një konstruksion i kohëve të fundit i pajisur me veshje termike kapote, një element kyç për të siguruar izolim termik efektiv. Megjithatë, konsumi vjetor i energjisë, rreth 24,000 kWh, duket relativisht i konsiderueshëm.


Duke marrë parasysh sipërfaqen e vogël të çatisë (rreth 600 m²) dhe numrin e kufizuar të punonjësve, ndikimi energjistik i kësaj ndërtese nuk është aq i madh sa mund të jetë në objekte të tjera me më shumë përdorues. Ky kombinim e bën ndërtesën e Zjarrfikëses jo prioritetare për investimin në panele fotovoltaike.

Në kontrast, ndërtesa e Komunës së Junikut, me rëndësi të veçantë për komunën, shquhet për gjendjen e shkëlqyer teknike dhe fizike, është e pajisur me sistem kapotë me efikasitet të lartë termik dhe dyer/dritare të termoizoluara me xham të dyfishtë, që

ofrojnë rezistencë ndaj kushteve atmosferike lokale.

Kjo ndërtesë është e pajisur me një sistem me panele fotovoltaike,që kontribuon në uljen e konsumit të energjisë elektrike dhe kostos së mirëmbajtjes dhe funksionimit të tij. Megjithatë, konsumi i energjisë është më i lartë se prodhimi nga panelet në këtë objekt. Sasia e energjisë që konsumohet është rreth 34,500 kWh, ndërkohë që sasia e energjisë që prodhohet është rreth 12,500 kWh në vit. Ndërtesa e Komunës është gjithashtu e lidhur me ndërtesën e sallës së Këshillit, e cili është shumë e përshtatshëm për instalimin e paneleve fotovoltaike, duke pasur drejtimin dhe hapësirën e duhur për t’i vendosur ato në mënyrë efikase, përfshirë shfrytëzimin optimal të hapësirës së çatisë. Për ngrohjen, Komuna përdor një sistem kaldaje me naftë, ku konsumi i naftës arrin në rreth 6,000 litra, ose 60,000 kWh energji ekuivalente, një sasi që është dukshëm më e lartë se konsumi i energjisë elektrike.

Figura 7. Harta e objekteve publike sipas cilësisë së ndërtesës në Komunën Junik



Burimi: Komuna Junik dhe përpunuar nga CoPLAN 2024

Tabela 19. Konsumi i energjisë në ndërtesat e arsimit

Emri i Institucionit Arsimor	Siperfaqja totale (m ²)	Konsumi specifik kWh/m ² vit	Konsumi total në vit kWh/vit
Kopështi	2,600	63,846	166,000
Shkolla Fillore	3,750	73,067	274,000
Shkolla e Mesme	9,856	16,843	166,000
Salla e sportit SHFMU "Edmond Hoxha"	4,000	22,500	90,000

Burimi: Komuna Junik 2024

Ndërtesat arsimore zënë grupimin më të madh të ndërtesave publike, të cilat janë pjesë e administratës publike vendore të Komunës së Junikut. Në këtë kategori përfshihen 4 ndërtesa të cilat janë: shkolla 9 vjeçare, palestra e shkollës 9 vjeçare, shkolla e mesme dhe objekti i kopështit.

Sa i përket konsumit të energjisë, Shkolla Fillore rezulton të ketë konsumin më të lartë, me rreth 274,000 kWh në vit. Po ashtu, edhe konsumi specifik në këtë ndërtesë është më i larti ndër të gjitha ndërtesat arsimore, duke arritur në rreth 73,067 kWh/m².

Ndërkohë, ndërtesat e Shkollës së Mesme dhe të Kopështit kanë një sasi të njëjtë të konsumit të përgjithshëm të energjisë, të vlerësuar në rreth 166,000 kWh në vit secila. Megjithatë, duke analizuar konsumin specifik, vërehet se ndërtesa e kopështit ka ndjeshëm një konsum më të lartë për metër katror krahasuar me shkollën e mesme.

Ndërtesa me konsumin më të ulët të energjisë është palestra e shkollës 9-vjeçare, me një konsum prej 90,000 kWh në vit dhe një konsum specifik prej 22.5 kWh/m².

Shkolla 9-vjeçare “Edmond Hoxha” në Junik ka potencial të mirë për vendosjen e paneleve fotovoltaike sepse është një ndërtesë tërësisht e re, e ndërtuar tre vitet e fundit. Kjo ndërtesë ka një veshje shumë të mirë të izolimit termik, po ashtu është e pajisur me dritare dhe dyer dopio xham me izolim të mirë termik. Sipërfaqja e konsiderueshme e shkollës, si dhe e palestrës, është një element tjetër mjaft i rëndësishëm në vendosjen e paneleve fotovoltaike në këtë ndërtesë. Në total, ndërtesa ka një sipërfaqe çatie rreth 4,800 m², e cila është një sipërfaqe e konsiderueshme për shfrytëzim për panele dhe është në gjendje shumë të mirë fizike.

Sa i përket energjisë së konsumuar, kjo ndërtesë ka një konsum relativisht të lartë prej 24,000 kWh në vit, si dhe 10,000 kWh në vit për palestrën. Ndërtesa e shkollës është institucioni i vetëm i arsimit 9-vjeçar në Junik dhe ka një numër të konsiderueshëm nxënësish, me rreth 504 nxënës, duke i shërbyer të gjithë komunitetit të Junikut. Të dyja ndërtimet, respektivisht palestra dhe shkolla, kanë sistem ngrohjeje me pelet dhe konsum vjetor 16 dhe 50 ton pelet, të cilat çlirojnë një energji termike prej 330,000 kWh, një sasi e lartë e energjisë së konsumuar në krahasim me energjinë elektrike.

Ndërtesa e Gjimnazit të Junikut është një nga ndërtesat publike me sipërfaqe të konsiderueshme në administrim të Komunës,

gjë që e bën mjaft të përshtatshme për të vendosur panele fotovoltaike. Kjo ndërtesë ka një gjendje të mirë fizike dhe teknike, e pajisur me izolim termik në veshje, dritare dhe dyer. Shkolla ka një sistem të paneleve fotovoltaike si rezultat i një konkursi të fituar nga vetë nxënësit, por i cili nuk është vënë në funksion. Ky fakt është mjaft pozitiv sepse lidhet me ndërgjegjësimin që ka ky komunitet i nxënësve për energjinë dhe sistemet e panelëve fotovoltaike.

Sa i përket konsumit të energjisë, ai shkon në rreth 16,000 kWh, që është relativisht mesatar si konsum. Sistemi i ngrohjes është me pelet dhe konsumon një sasi vjetore prej 40 ton pelet, e cila çliron një energji termike prej 180,000 kWh, që është një sasi e lartë e energjisë e konsumuar në krahasim me energjinë elektrike.

Ndërtesa e Çerdhes/Kopështit të Junikut ka pësuar një rikonstruksion total në brendësinë e saj para pak vitesh dhe gjendja e saj paraqitet mjaft e mirë. Ajo është e pajisur me izolim termik, një element kyç për eficiencën e energjisë, po ashtu dyert dhe dritaret janë të pajisura me dopio xham të përshtatshëm për izolim termik. Sipërfaqja e kësaj ndërtese është e konsiderueshme, gjë që e bën të përshtatshme për ndërtimin dhe vendosjen e paneleve fotovoltaike.

Ndërtesa nuk ka pasur rikonstruksion në aspektin konstruktiv. Përpara se të përdoret si Çerdhe/ Kopësht ndërtesa është përdorur si shkollë, rikonstruksioni është bërë për të rehabilituar për nevojat e një çerdheje, por pa prekur sistemin konstruktiv. Ndërtesa ka sistem ngrohjeje me pelet dhe konsumon një sasi vjetore prej 40 ton pelet në vit, e cila çliron një energji termike prej 180,000 kWh, që është një sasi e lartë e energjisë e konsumuar në krahasim me energjinë elektrike. Sa i përket energjisë elektrike të konsumuar, ajo paraqitet rreth 16,000 kWh dhe kjo ndërtesë i shërben rreth 50 fëmijëve të Komunës së Junikut.

Tabela 20. Konsumi i energjisë në ndërtesat e shëndetësisë

Emri i Institucionit Shëndetësor	Siperfaqja totale (m2)	Konsumi specifik kWh/m2 vit	Konsumi total në vit kWh/vit
QKMF	2,020	57,293	115,732

Burimi: Komuna Junik 2024

QKMF është ndërtesa e vetme e sektorit të shëndetësisë në Komunën e Junikut dhe ofron shërbim 24 orë në ditë. Për shkak të funksionit të saj, komforti termik është veçanërisht i rëndësishëm. Ndërtesa mbulon të gjithë shërbimin shëndetësor të komunës, duke u shërbyer një numri të madh qytetarësh, me rreth 37,000 përdorues gjatë vitit të fundit. Për të siguruar funksionimin e saj të pandërprerë, Komuna e Junikut ka investuar vazhdimisht në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të saj.

Konsumi total vjetor i energjisë në QKMF arrin në 115,732 kWh, ndërsa konsumi specifik është relativisht i lartë në krahasim me ndërtesat e tjera, duke arritur në rreth 57.2 kWh/m². Kjo pasqyron nevojën për një menaxhim më të mirë të energjisë, për të përmirësuar efikasitetin energjetik të ndërtesës, duke qenë se është një institucion që operon 24 orë dhe ka një përdorim të lartë nga qytetarët.

Sa i përket konstruksionit të ndërtesës, gjendja e saj është mjaft e mirë në përgjithësi dhe nuk ka amortizime të dukshme në strukturë. Veshja e fasadës është termike dhe dritaret dhe dyert janë të pajisura me dopio xham, që sigurojnë izolim termik.

Konstruksioni i çatisë është i kombinuar, me elementë si mahitë (12/14 cm), shtyllat (10/10 cm), danat (2x2.5x25 cm), trau i kurorës (10/12 cm), pajandrat (10/16 cm), dhe listellat (3/5 cm). Mbulesa e çatisë realizohet duke filluar nga poshtë lart, me vendosjen e letrës së zezë, listellave dhe montimin e llamarinës së plastifikuar dhe të valëzuar. Pjerrësia e rrafshit të kulmit është 15 gradë.

7.1.2 Objektet Rezidenciale dhe Tregtare

Konsumi energjetik në sektorin rezidencial dhe komercial në Komunën e Junikut përbën pjesën më të madhe të konsumit total të energjisë, ndaj është e domosdoshme që programet dhe projektet për eficiencën e energjisë të fokusohen edhe në këtë grup, për të nxitur aplikimin e parimeve të eficiencës në të gjithë territorin e komunës.

Sipas të dhënave të vitit 2023, në Komunën e Junikut janë regjistruar rreth 1,288 kontrata rezidenciale dhe 182 kontrata tregtare për furnizim me energji elektrike. Nga analiza e të dhënave të KEDS-it për konsum vjetor sipas tremujorëve rezulton se:

- në tremujorin e parë konsumi arrin në 1.94 GWh,
- në tremujorin e dytë bie në 1.43 GWh,
- në tremujorin e tretë vazhdon rënia në 1.35 GWh,
- ndërsa në tremujorin e katërt ka një rritje në 1.58 GWh.

Gjatë periudhës së hartimit dhe zbatimit të PVEK në Komunën e Junikut, roli i komunës është thelbësor në orientimin e sektorit privat drejt mundësive për rritjen e eficiencës. Ky orientim do të mbështetet kryesisht nga Fondi për Eficiencën e Energjisë, i menaxhuar nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Objektivi për këtë sektor është një reduktim prej 17% të konsumit të energjisë, në përputhje me objektivat kombëtare minimale.

Po ashtu, me fillimin e zbatimit të planit, në të gjitha ndërmarrjet e reja ndërtimore në

territorin e komunës duhet të parashikohen sisteme për prodhimin e energjisë nga

burime diellore, si një mënyrë shtesë për të reduktuar konsumin energjetik në nivel lokal.

Tabela 21. Konsumi energjitik në sektorin privat sipas tremujorëve në Komunën Junik

Sektori	Tremujori I [kWh]	Tremuroji II [kWh]	Tremujori III [kWh]	Tremujori IV [kWh]	Total viti 2023 [kWh]
Konsumatorë Komecial* 10 kV (1/3)	14,048	27,488	9,120	10,808	61,464
Konsumator Komericial (6/6, 7/02, 7/01)	407,219	330,853	342,071	328,168	1,408,310
Konsumator shtëpiak 4/01, 4/02)	1,941,534	1,430,779	1,356,252	1,582,000	6,310,565
Ndriçim Publik (8/01)	18,202	18,266	15,871	20,608	72,947
Total	2,381,003	1,807,386	1,723,314	1,941,584	7,853,286

Burimi: Komuna Junik 2024

Sa i përket konsumatorëve komercialë, trendi i konsumit të energjisë elektrike në Komunën e Junikut gjatë vitit paraqitet relativisht i qëndrueshëm, me luhatje të lehta mes tremujorëve. Konsumi më i lartë është regjistruar në tremujorin e parë me 0.407 GWh, pasuar nga një rënie në tremujorin e dytë me 0.33 GWh. Më pas, në tremujorin e tretë është vërejtur një rritje e lehtë në 0.34 GWh, ndërsa vlera më e ulët është shënuar në tremujorin e katërt me 0.32 GWh.

Në lidhje me sektorin 10 kV*, që përfshin biznese me karakteristika dhe nevoja teknike të veçanta për furnizim me energji, në komunë është i pranishëm vetëm një subjekt. Konsumi më i lartë për këtë sektor është shënuar në

tremujorin e dytë, i ndjekur nga ai i parë dhe i katërt, ndërsa tremujori i tretë ka shënuar konsumin më të ulët gjatë vitit.

1.3 Transporti Publik dhe Mjetet e Transportit në Pronësi të Komunës

Reduktimi i konsumit të energjisë nga sektori i transportit përbën një ndër fokuset kryesore të Planit Komunal për Veprim në Eficiencën e Energjisë në Komunën e Junikut (PKVEK). Qëllimi është të rritet efienca energjetike dhe të ulen emetimet e gazrave serrë, të cilat përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të ndotjes si pasojë e aktivitetit të transportit.

Tabela 22. Flota e automjeteve dhe konsumi energjetik i tyre

Institucioni	Numri i automjeteve	Litra/Naftë në vit Viti 2023	Energjia kWh
Administrata komunale	10	15,024	150,242
QKMF	2	1,400	14,000
Qendra sociale	1	600	6,000
Zjarrfikësit	2	690	6,900
Transporti i nxënësve	1	3,700	37,000
Eko regjioni	1	4,231	42,308
Total	17	25,645	256,450

Burimi: Komuna Junik 2024

Të dhënat e disponueshme për sektorin e transportit në Komunën e Junikut i përkasin kryesisht përdorimit të automjeteve publike, pasi mungojnë të dhëna të strukturuar për automjetet private në nivel lokal. Siç paraqitet në tabelën përkatëse, pjesën më të madhe të konsumit të energjisë e zënë automjetet në pronësi të komunës, të cilat për vitin 2023 kanë shpenzuar mbi 15 mijë litra naftë, ekuivalente me rreth 150,000 kWh energji.

Në krahasim me këtë, transporti i nxënësve përmes një autobusi të dedikuar konsumon më pak - rreth 3,700 litra ose 37,000 kWh. Automjetet e QKMF-së, megjithëse në shërbim të përditshëm, kanë konsumuar më pak se një e treta e kësaj sasive, me 1,400 litra (14,000 kWh). Më poshtë renditen automjetet e shërbimit zjarrfikës dhe ato të qendrës sociale, të cilat kontribuojnë me konsum më të ulët: përkatësisht 6,900 kWh dhe 6,000 kWh.

Këto të dhëna tregojnë një shpërndarje të qartë të konsumit të energjisë, ku automjetet komunale përbëjnë barrën kryesore, ndërsa shërbimet e specializuara, si emergjencat apo transporti social, zënë një peshë më të vogël në totalin e konsumit energjetik.

7.1.4 Shërbimi i Mbetjeve dhe Transporti i Tyre

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve përbën një nga sektorët me ndikim të drejtpërdrejtë në konsumimin e karburanteve fosile, veçanërisht të naftës, duke kontribuar në mënyrë të ndjeshme në konsumimin total të energjisë dhe emetimin e CO₂. Për shkak të natyrës së tij intensive në lëvizje dhe logjistike, ky shërbim përfaqëson një potencial të konsiderueshëm për përmirësim të efijencës energjetike, si dhe për reduktimin e gjurmës karbonike në nivel lokal.

Tabela 23. Specifikimet mbi transportin e mbetjeve


Lloji i mjetit	Sasia	Konsumi litra Naftë	Energjia kWh	Çmimi për litër Naftë
Kamion	1	4,230	42,300	1.39

Burimi: Komuna Junik 2024

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve, i ofruar nga Ekoregjioni në Komunën e Junikut, është një faktor i rëndësishëm lidhur me konsumin e energjisë dhe emetimin e CO₂. Ky shërbim realizohet me një automjet, i cili gjatë vitit 2023 ka konsumuar rreth 4,230 litra naftë, ekuivalente me 42,300 kWh energji. Për të reduktuar konsumimin e energjisë dhe emetimet, është e nevojshme të përmirësohet efikasiteti i transportit

të mbetjeve. Kjo mund të arrihet përmes përdorimit të mjeteve më të reja dhe më efikase, me nivel të ulët të emetimit të gazrave. Po ashtu, optimizimi i rrugëve të pastrimit dhe zgjerimi i mbulimit të shërbimit nëpërmjet përmirësimit të aksesit në disa zona mund të kontribuojnë në uljen e kohës që makineritë kalojnë në punë, duke rezultuar në kursim energjie dhe reduktim të ndotjes.

Figura 8. Harta e itinerarit të transportit të mbetjeve Komuna Junik



Burimi: Komuna Junik 2024

7.1.5 Sherbimi i Ndrçimit Publik


Shërbimi i ndriçimit publik në Komunën e Junikut është një komponent kyç i infrastrukturës urbane, i cili ka një ndikim të drejtpërdrejtë në konsumimin e energjisë elektrike. Si një element thelbësor i menaxhimit të energjisë në nivel lokal, ai luan një rol të rëndësishëm në strategjitë për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe në uljen e shpenzimeve të energjisë.

Sipas të dhënave të disponueshme nga KEDS, konsumi i energjisë për shërbimin e ndriçimit publik në Komunën e Junikut ka variacione sezonale. Konsumi më i lartë regjistrohet në

tremujorin e katërt, me një total prej rreth 20,607 kWh. Pas këtij tremuori, konsumi është më i lartë në tremujorët e parë dhe të dytë, secili me rreth 18,200 kWh. Ndërsa, tremujori i tretë paraqet konsumin më të ulët të energjisë gjatë vitit.

Ky informacion është i rëndësishëm për hartimin e strategjive të përmirësimit të efikasitetit të energjisë, pasi ndihmon në identifikimin e periudhave me konsum të lartë. Këto periudha mund të shfrytëzohen për të zbatuar masa të kursimit të energjisë dhe përmirësimin e teknologjive të ndriçimit.

Figura 9. Harta e akseve rrugore të ndriçuara



Burimi: Komuna Junik 2024

Në Komunën e Junikut, shërbimi i ndriçimit publik shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 55 km linear dhe 97,800 m². Teknologjia e përdorur për llambat është teknologjia LED, me gjithsej 1,300 llamba, të cilat sigurojnë efikasitet dhe kursim energjie. Ky shërbim ka ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm në konsumimin e energjisë, por edhe në aspekte të tjera sociale dhe ekonomike të komunitetit.

Ndriçimi publik është një komponent thelbësor për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve, pasi siguron kushte më të sigurta për lëvizjen në mjediset publike gjatë natës, duke ulur rrezikun e aksidenteve dhe krimeve. Një ndriçim efikas dhe i mjaftueshëm rrit nivelin e sigurisë dhe komoditetit për banorët, përmirëson cilësinë e jetesës dhe kontribuon në një ambient më

të sigurt dhe funksional për të gjithë anëtarët e komunitetit.

Për më tepër, ndriçimi publik ka një ndikim pozitiv në zhvillimin e aktiviteteve sociale dhe kulturore në hapësirat publike. Infrastruktura e mirë, ndriçimi mund të krijojë mundësi për organizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve në orët e vona të natës, duke aktivizuar komunitetin dhe promovuar bashkëveprimin social. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për zonat urbane, ku hapësirat publike janë shpesh të mbushura me aktivitete pas perëndimit të diellit.

Nga pikëpamja ekonomike, përdorimi i sistemeve të ndriçimit LED mund të ndihmojë në uljen e kostove të energjisë për komunën, duke mundësuar alokimin e më shumë burimesh për investime të tjera të

zhvillimit të komunitetit. Kursimi i energjisë mund të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe mund të mbështesë projekte të tjera që synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e iniciativave lokale për të rritur mirëqenien e qytetarëve. Në këtë kontekst, ndriçimi publik jo vetëm që është një element thelbësor për sigurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve shoqërore, por ka gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e një ambienti të sigurt dhe funksional për të gjithë anëtarët e komunitetit.

7.1.5 Analiza e Varferisë Energjetike

Varfëria energjetike është një fenomen që prek shumë individë dhe familje në Kosovë, duke u shfaqur si një mungesë e aksesit në shërbime të energjisë së mjaftueshme dhe të përballueshme për të mbajtur kushte të pranueshme jetese, siç janë ngrohja dhe energjia elektrike për përdorime të përditshme. Ky fenomen ka ndikim të thellë në shëndetin dhe mirëqenien e individëve, si dhe në cilësinë e jetesës së tyre. Familjet që janë të prekura nga varfëria energjetike shpesh përballen me sfida të shumta, përfshirë ngrohjen e pamjaftueshme gjatë dimrit, vështirësi në përdorimin e pajisjeve elektrike dhe një rendiment të ulët në fushat e tjera të jetesës, për shkak të mungesës së mundësive për energji të qëndrueshme dhe efikase.

Në përmbledhje, varfëria energjetike ka lidhje të drejtpërdrejtë me varfërinë e përgjithshme ekonomike, dhe familjet e prekura janë ato që kanë të ardhura të ulëta, kushte të vështira të jetesës, dhe shpesh nuk kanë mundësi për të investuar në teknologji të efikasitetit të energjisë ose për të kryer pagesa të rregullta për shërbimet e energjisë. Për të kuptuar më mirë përhapjen dhe ndikimin e varfërisë energjetike, është e rëndësishme të shqyrtohen disa elemente kyçe që lidhen me gjendjen sociale, ekonomike dhe infrastrukturale të komuniteteve.

Së pari, varfëria energjetike prek më së shumti personat dhe familjet me të ardhura të ulëta, veçanërisht ato që jetojnë në kushte të pasigurta banimi. Kjo përfshin individët që jetojnë në ndërtesa të vjetra apo të papërshtatshme për kushtet klimatike, ku mungojnë sistemet moderne të ngrohjes dhe izolimit. Njerëzit që jetojnë në zona të izoluara dhe periferike, si fshatrat dhe zonat malore, shpesh përballen me sfida më të mëdha në aksesin ndaj energjisë dhe për pasojë janë më të rrezikuara nga varfëria energjetike në krahasim me ata që banojnë në qytete.

Në këtë kontekst, nevojat për strehim dhe shërbime sociale janë të theksuara. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë që vuan nga varfëria energjetike ka nevojë për ndihmë dhe mbështetje sociale. Grupet më të prekura përfshijnë pensionistët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me shumë fëmijë. Kjo kërkon nga autoritetet publike, si qeveria dhe komunat, që të hartojnë plane të posaçme për strehim të përshtatshëm dhe të ofrojnë mbështetje direkte për menaxhimin e kostove të energjisë, në mënyrë që të ndihmojnë këto kategori të cënueshme.

Zonat më të prekura nga varfëria energjetike janë kryesisht ato rurale dhe periferike, ku ndodhen shtëpi të vjetra, pa izolim termik dhe pa qasje të mirë në infrastrukturën energjetike. Edhe brenda qyteteve, disa lagje me kushte të vështira banimi përballen me të njëjtat probleme. Për banorët e këtyre zonave, siguri i ngrohjes gjatë dimrit dhe përdorimi i energjisë për nevoja bazë mbetet një sfidë e përditshme.

Për të zbutur varfërinë energjetike, është e domosdoshme zbatimi i planeve që promovojnë efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e energjive të rinovueshme. Kjo mund të realizohet përmes subvencioneve për energji për familjet në nevojë, instalimit të sistemeve efikase të ngrohjes dhe izolimit në shtëpitë e vjetra, si dhe përmirësimit të përgjithshëm të kushteve të jetesës për individët dhe familjet më të rrezikuara.

Komunat mund të shfrytëzojnë fonde vendore dhe ndërkombëtare, si dhe projekte zhvillimi, për të mbështetur këto nisma.

Ndërhyrjet që mund të kenë ndikim përfshijnë rritjen e investimeve në infrastrukturë energjetike që përdor burime të rinovueshme si energjia diellore dhe ajo nga era, për të përmirësuar qasjen

në energji për komunitetet e varfra. Po ashtu, përmirësimi i efikasitetit të energjisë nëpërmjet instalimit të pajisjeve efikase dhe mbështetja me ndihmë financiare për ata që nuk përballojnë dot faturat e larta, janë hapa të domosdoshëm. Këto masa janë thelbësore për të siguruar një shoqëri më të drejtë, ku çdo qytetar të ketë akses të barabartë dhe të përballueshëm në energji të qëndrueshme.

8. ANALIZA E EMETIMEVE TË GAZEVE TË EFEKTIT SERRË

Emetimet e gazeve serrë, veçanërisht ato të dioksidit të karbonit (CO₂), përbëjnë një shqetësim të madh për mjedisin dhe klimën në Kosovë. Ndikimi më i madh vjen nga sektori i energjisë, i cili është kontribuesi kryesor i këtyre emetimeve, për shkak të përdorimit të linjitit si burim primar për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet.

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2020 emetimet e CO₂ arritën në 8,409 Gg (gigagramë). Duke iu referuar të dhënave të mëparshme, në vitin 2012 emetimet për kokë banori në Kosovë ishin 5.4 tonë ekuivalent CO₂, një vlerë më e ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian, por pak më e lartë se mesatarja globale, sipas Raportit Gjithëpërfshirës të Mjedisit të vitit 2015.

Burimet kryesore të emetimeve të CO₂ janë të lidhura ngushtë me sektorin e energjisë,

ku termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” kishin emetuar përkatësisht 1,532,930 tonë dhe 3,608,874 tonë CO₂ në vitin 2006. Përveç energjisë, edhe sektori industrial kontribuon ndjeshëm në nivelin e përgjithshëm të ndotjes. Në vitin 2019, prodhimi i çimentos llogaritej për rreth 91% të emetimeve të CO₂ nga industria, ndërsa prodhimi i hekurit dhe nikelit për 5.6%.

Duke analizuar trendin e emetimeve nga viti 2014 deri në vitin 2019, shihet se niveli vjetor i CO₂ ka variuar ndërmjet 216 dhe 250 Gg. Në vitin 2019 është vërejtur një tendencë e lehtë rënjeje në krahasim me dy vitet paraprake, sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës në raportin për emetimet e gazeve serrë. Kjo tendencë mund të lidhet me ndryshimet në aktivitetin industrial, përmirësimet në efikasitetin energjetik apo masa të ndërmarra për reduktimin e ndotjes.

Tabela 24. Konsumi i CO₂ në raport me konsumin e energjisë

Lloji i energjisë dhe njesia	Sasia në vit	Vlera energjitike (kWh)	Koeficientët CO ₂ kg/kWh	Emetimet CO ₂ eq (kg)
Energjia elektrike (KWh)	7,912,339	7,912,339	1.438	11,377,943.48
Karburant për transport-Dizel (Litra)	25,645	256,640	0.272	69,754.51
Karburant për transport Benzine (litra)	0	0	0	0
Lëndë djegësie drusore (m3)	0	0	0	0
Lëndë djegëse Pellet (kg)	146,000	708,100	0.031	21,951.10
Lëndë djegëse naftë (litra)	13,000	130,000	0.272	35,360.00
Totali		8,697,985		11,505,009.09

Burimi: Komuna Junik dhe Përpunuar nga CoPLAN 2024

Analiza e emetimit të gazrave serrë në Komunën e Junikut përqendrohet në tre sektorë kryesorë të konsumit energjetik: ndërtesat (si publike ashtu edhe private), ndriçimi publik dhe sektori i transportit. Llogaritja e emetimit të CO₂ është kryer për secilin burim energjetik në bazë të sasisë së konsumuar, duke përdorur faktorët përkatës të emetimit për çdo lëndë djegëse ose burim fundor energjie.

Faktorët e emetimit janë bazuar në Rregulloren Nr. 02/18 për Metodologjinë Kombëtare për Kalkulimin e Performancës së Integruar Energjetike të Ndërtesave si dhe në udhëzuesin për raportim të "Covenant of Mayors for Climate and Energy" (2016), të cilët përshkruajnë koeficientët të caktuar për secilin burim energjetik sipas karakteristikave të tij.

Për vitin 2023, konsumi total energjetik në Komunën e Junikut është vlerësuar në 8.697 milion kWh, nga i cili janë prodhuar rreth 11.5 milion kg CO₂. Nga kjo sasi, afërsisht 11.37 milion kg CO₂ janë gjeneruar nga konsumi i energjisë elektrike.

Objektivi kryesor i këtij plani është përmirësimi i efijencës së energjisë në nivel lokal, duke kontribuar në uljen e ndjeshme të emetimeve të CO₂ dhe përmirësimin e kushteve mjedisore. PKVEK Junik do të shërbejë si udhëzues për zbatimin e masave konkrete që synojnë reduktimin e konsumit të energjisë dhe kostove përkatëse, duke ruajtur njëkohësisht mjedisin.

Sipas të dhënave të përmbledhura, nga ndërhyrjet e planifikuara pritet një reduktim prej 2.091 milion kWh energji dhe 2.096 milion kg CO₂ equivalent deri në vitin 2030.

Reduktimi i emetimeve do të arrihet përmes masave në sektorë të ndryshëm:

- **Ndërtesat private:** Synohet një reduktim minimal prej 17% të emetimeve të CO₂ nga objektet që konsumojnë energji. Ky objektivi do të arrihet përmes bashkëpunimit publik-privat dhe zbatimit të skemave mbështetëse për instalimin e paneleve fotovoltaike, si dhe përmirësimit të standardeve të ndërtimit në drejtim të efijencës së energjisë.
- **Asetet publike:** Objektivi është reduktimi i emetimeve të CO₂ deri në 70% nga konsumi i energjisë në institucionet publike, që do të realizohet në kuadër të projektit "EFFORT" dhe investimeve të vazhdueshme në ndërtesa publike dhe ndriçim.
- **Transporti:** Në sektorin e transportit publik dhe atij të ndërmarrjeve shtetërore që operojnë në territorin e komunës, synohet që emetimet e CO₂ të reduktohen me 30%.

Këto objektiva do të jenë të matshme dhe të monitorueshme deri në vitin 2030, vit i cili përkon edhe me rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Energji dhe Klimë të Republikës së Kosovës.

Tabela 25. Reduktimi i energjisë dhe i CO₂ me implementimin e masave të PKVEK Junik

	Para masave të PKVEK		Pas masave të PKVEK	
	Konsumi energjetik kWh	Konsumi CO ₂ kg	Konsumi energjetik kWh	Emetimet CO ₂ eq (kg)
Ndërtesat Private	7,718,875.61	11,099,743.13	6,406,666.76	9,212,786.80
Ndërtesat Publike	982,986.54	244,179.00	292,895.97	73,253.70
Ndriçimi Publik	72,947.03	104,897.83	60,546.041	87,065.20
Transporti	256,640.4	69,806.19	179,648.27	48,864.33
Total	9,031,449.58	11,518,758.03	6,939,169.63	9,421,970.03

Burimi: Komuna Junik dhe Përpunuar nga CoPLAN 2024

9. VIZIONI I PLANIT

Vizioni i PKVEK për Komunën e Junikut shkon përtej periudhës së zbatimit të këtij dokumenti strategjik dhe synon të udhëheqë vendimmarrjen afatgjatë lokale në fushën e energjisë dhe klimës. Ai orienton politikat komunale drejt një zhvillimi të qëndrueshëm, ku përmirësimi i efijencës energjetike dhe reduktimi i emetimeve të CO₂ shihen si hapa thelbësorë në përballimin e ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët.

Në thelb të këtij vizioni qëndron bashkëpunimi i ngushtë midis komunitetit dhe autoriteteve vendore. Këta dy aktorë luajnë një rol të pazëvendësueshëm në marrjen e masave konkrete për një sistem energjetik më të pastër, më të qëndrueshëm dhe më të drejtë social. Komuna Junik angazhohet të zhvillojë një sektor energjetik të qëndrueshëm, duke ulur gjurmën e karbonit dhe duke përforcuar aftësinë për t'u përshtatur me ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Ky vizion ndërtohet mbi një qasje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese. Ai synon të përfshijë qytetarët, bizneset dhe institucionet publike në një proces të përbashkët për të realizuar objektivat për energjinë e pastër dhe tranzicionin e gjelbër në nivel lokal. Për të përmbushur këtë vizion, Komuna do të integrojë parimet e tranzicionit të drejtë dhe të qëndrueshëm në politikat e zhvillimit të territorit, duke garantuar pjesëmarrje aktive, transparencë dhe koordinim ndërinstitutional.

PKVEK i Junikut nuk është vetëm një plan teknik, por një instrument udhëzues për një të ardhme më të qëndrueshme, ku energjia prodhohet dhe konsumohet në mënyrë efikase, ku burimet natyrore mbrohen dhe ku qytetarët janë bashkë-krijues të zgjidhjeve për sfidat klimatike. Përmes këtij vizioni, Komuna Junik afirmon përkushtimin e saj për të qenë pjesë aktive e përpjekjeve kombëtare dhe rajonale në kuadër të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe për të kontribuar në realizimin e objektivave të Marrëveshjes së Parisit dhe integritimit evropian.

10. PROJEKTET DHE MASAT E NDËRMARRA/ PLANI I VEPRIMIT

PKVEK Junik përfshin programe dhe projekte të detajuara, të cilat janë të kostuara, të renditura sipas prioritetit dhe të shoqëruara me indikatorë monitorimi. Gjithashtu, ai përcakton burimet e mundshme të financimit, që mund të përfshijnë donatorët, qeverinë apo fondet e brendshme. Ky plan mbështetet në gjashtë programe zhvillimore, të cilat janë të strukturuar sipas ndarjes sektoriale të efijencës së energjisë, duke përfshirë edhe masa për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e përfitimeve që sjell zbatimi i këtyre parimeve.

Më poshtë janë të renditura programet zhvillimore të cilat janë të detajuara në projekte sipas fushave të programit:

- **Programi për Efijencën e Energjisë në Ndërtesat Publike** fokusohet në përmirësimin e efijencës energjetike të ndërtesave publike, përfshirë rehabilitimin e ndërtesave administrative dhe instalimin e sistemeve PV. Masat kryesore përfshijnë rinovimin e veshjeve termike dhe instalimin e paneleve diellore për të ulur konsumimin e energjisë dhe për të rritur performancën e ndërtesave
- **Programi për Efijencën e Ndrëçimit Publik** është përmirësimi i sistemit të ndriçimit publik përmes instalimit të ndriçimit diellor dhe sistemeve LED. Masat kyçe përfshijnë ndërrimin e llampave tradicionale me llamba LED, vendosjen e paneleve PV

dhe audite energjetike për optimizimin e konsumit. Programi për eficiencën e energjisë në sektorin rezidencial

- **Programi për Eficiencën e Energjisë në Sektorin Rezidencial** synon përmirësimin e eficiencës energjetike të ndërtesave private, përmes ndriçimit efikas dhe instalimit të sistemeve PV. Masat kryesore përfshijnë incentivimin e instalimit të paneleve PV, përdorimin e sistemeve të ngrohjes efikase dhe përditësimin e kodeve të ndërtimit për të garantuar përputhshmërinë me standardet e energjisë.
- **Programi për Eficiencën e Energjisë në Sektorin Komerical dhe të Biznesit** përqendrohet në mbështetje për bizneset që investojnë në eficiencën energjetike dhe energjinë diellore. Masat përfshijnë instalimin e paneleve PV, zbatimin e kodeve të ndërtimit të qëndrueshëm dhe krijimin e databazave për monitorimin e konsumit të energjisë.
- **Programi për Eficiencën Energjike të Lëvizshmërisë** synon përmirësimin e transportit urban dhe përdorimin e energjisë së pastër. Masat kyçe përfshijnë blerjen e automjeteve hibride dhe elektrike, ndërtimin e rrugëve për biçikleta dhe krijimin e infrastrukturës për karikimin e automjeteve elektrike.
- **Programi për Nxitjen e Parimeve të Eficiencës së Energjisë në Nivel Lokal** fokusohet në nxitjen e përdorimit të energjisë të rinovueshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për eficiencën energjetike. Masat përfshijnë krijimin e hartës diellore, realizimin e fushatave edukative dhe përditësimin e studimeve të fizibilitetit për burime të rinovueshme.

Në kuadër të Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë, veprimet e planifikuara për të përmbushur objektivat e dekarbonizimit dhe përmirësimit të eficiencës së energjisë janë strukturuar në dy drejtime kryesore: projektet dhe masat. Këto dy shtylla përbëjnë bazën e qasjes së integruar për të ndikuar pozitivisht si në aspektin mjedisor, ashtu edhe në atë ekonomik dhe social të komunitetit.

Projektet përfaqësojnë ndërhyrje konkrete dhe shpesh kapitale, të cilat kërkojnë investime të drejtpërdrejta për modernizimin e infrastrukturës ekzistuese apo zhvillimin e teknologjive të reja. Ato synojnë të arrijnë rezultate të matshme në reduktimin e konsumit të energjisë dhe të emetimeve të CO₂, përmes përmirësimeve në ndërtesat publike dhe private, sektorin e ndriçimit publik, apo edhe në sistemet e ngrohjes dhe ftohjes.

Nga ana tjetër, masat janë ndërhyrje mbështetëse dhe zakonisht administrative që ndihmojnë në lehtësimin dhe përsheptimin e procesit të zbatimit të objektivave të PKVEK. Ato përfshijnë rregullore, udhëzime, skema nxitëse, ndërgjegjësim publik, trajnime dhe mekanizma monitorimi, të cilat i mundësojnë komunës dhe aktorëve të tjerë lokalë të koordinojnë më mirë veprimet e tyre dhe të sigurojnë një zbatim të qëndrueshëm dhe të qëllimshëm të masave për klimën dhe energjinë.

10.1 PROJEKT-FISHAT SIPAS PROGRAMEVE

Në vijim të analizës së përgjithshme të eficiencës energjetike në nivel lokal, ky nënkapitull thellohet në shqyrtimin e detajuar të burimeve energjetike që

PS.1	Programi Strategjik për eficiencën energjetike të ndërtesave Komunale
Ky program strategjik synon rehabilitimin e plotë të aseteve publike komunale (SHFMU “Edmond Hoxha” dhe Gjimnazi “Kuvendi i Junikut”, QKMF, Objekti i Komunës, Kopështi, Qendra Sociale dhe Zyra e Turizmit) të cilat kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike, ulin ndjeshëm kostot operative të energjisë duke reduktuar konsumin po ashtu duke reduktuar emetimet e GS në atmosferë.	

PS.1		Programi Strategjik për eficiencën energjitike të ndërtesave Komunale	
Projekti / Masa	Lloji i masës		Indikator
P 1.1	Rehabilitimi i plotë i ndërtesave administrative të komunës së Junikut në kuadër të rritjes së eficiencës së energjisë: a) Rinovimi i veshjeve termike duke përfshirë edhe dritaret dhe dyert b) rinovimi i mbulesave të ndërtesave, c) Modernizimi i sistemeve të ngrohjes së ndërtesave. Në masën 50% (këtu përfshihen të gjithë objektet në administrim të komunës Junik)	Projekt	Numri i Ndërtesave të rehabilituara (numër dritarësh, dyersh, çati të rehabilituara, fasada me sistem kapotë)
P 1.2	Ndërtimi e paneleve PV në çatitë e ndërtesave publike me kapacitet të instaluar për të mbuluar 40% deri në 60% të sasisë së konsumit energjitik.	Projekt	Numëri i paneleve PV të instaluata
P 1.3	Përditësimi i inventarit të ndërtesave publike komunale, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i konsumit të energjisë	Masë administrative	Krijimi i databazës
P 1.4	Programi i ndërgjegjësimit për eficiencën e energjisë në shkolla	Masë jo-strukturore	Realizimi i dy eventeve të tilla
P 1.5	Trajnimi i kujdestarëve/ menaxherëve të energjisë	Masë Administrative	Numri i kujdestarëve të trajnuar
Kosto Totale	Shih Planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2025-2028		
Prioritarizimi	Në këtë kontekst prioritar shihen 2 projektet që kanë të bëjnë me rehabilitimin e ndërtesave po ashtu edhe me instalimin e paneleve PV në objektet e ndërtesave. Në këto dy projekte synohet që rreth 70% e tyre të mbarojnë në 2 vitet e para të implementimit të Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë. Po ashtu sa i përket masave administrative duhet të jenë të implementuara në përfundim ligjshmërisë së Planit.		

PS.2	Programi për eficiency e energjisë në shërbimin e ndriçimit publik		
Ky program strategjik synon rehabilitimin dhe reduktimin e konsumit të energjisë elektrike nga ndriçimi publik, gjithashtu ndërtimin e linjës së re të ndriçimit në zona të largëta të pajisura me panele PV në shtyllat e ndriçimit dhe optimizon shërbimin e ndriçimit publik duke përmirësuar dhe aspektet e monitorimit dhe performancës			
Projekti / Masa		Lloji i masës	Indikator
P 2.1	Vendosja e linjave të ndriçimit publik me PV në zonat e largëta të cilat nuk kanë nevojë për furnizim elektrik.	Projekt	Numri i shtyllave me panele PV

PS.2	Programi për eficiencën e energjisë në shërbimin e ndriçimit publik		
P 2.2	Program i ngritjes së kapaciteteve të rinovimit të ndriçimit, dhe i teknologjive të avancuara të mirëmbajtjes	Masë administrative mirebajtje	Numëri i shtyllave të rehabilituara
P 2.3	Përditësimi i inventarit të ndriçimit, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i konsumit të energjisë.	Masë administrative	Krijimi i databazës
P 2.4	Auditimet energjetike, projektimi i detajuar inxhinierik dhe dokumentet e tenderit	Masë jo-struk-turore	Hartimi i auditimeve dhe i TORs
Kosto Totale	<i>Shih planin e veprimit</i>		
Kohëzgjatja	2025-2028		
Prioritarizimi	Në këtë kontekst prioritar shihen 2 projektet që kanë të bëjnë me rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e e sistemit të ndriçimit urban apo dhe zgjerimin e tij në zona të largëta të komunës po ashtu edhe projekti për mirëmbajtjen e tyre. Ndërkohë projektet apo ndërhyrjet e lehta kanë të bëjnë me ngritje database dhe monitorim të performancës së këtij sistemi apo përgatitje te dokumenteve teknike te tenderimit te cilat do te plotësohen deri ne fund të ligjshmërisë së planit.		

PS.3		Programi për eficiency e energjise të sektorit rezidencial në Komunën e Junikut	
Ky program strategjik synon rehabilitimin dhe reduktimin e konsumit te energjise elektrike në sektorin rezidencial privat në gjithashtu rehabilitimin e ndriçimit të ambjenteve të përbashkëta të banimit apo zhvillimin e PV solare si iniciativa private të cilat mbështeten nga Qeveria qendrore. Ky zhvillim do të ketë impakt të madh në reduktimin e konsumit të energjise elektrike po ashtu dhe reduktimin e emetimeve të GS.			
Projekti / Masa		Lloji i masës	Indikator
P 3.1	Ndriçimi efikas në hapësirat publike të ndërtesave kolektive të banimit (shkallaret dhe LED me sensor)	Projekt	Numri i llambave LED të instaluar në ambjentet e përbashkëta të ndërtimeve kolektive
P.3.2	Programi për incetivimin e PV në çatitë e objekteve private për rritjen e prodhimit të energjise së pastër dhe reduktimin e GES	Projekt	Numri i paneleve PV te instaluar
P 3.3	Ulja e taksës së Pronës dhe e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja me teknologji SMART per eficiency e energjise. Masë administrative	Masë administrative	Numri i ndërtimeve me sisteme për performancën energjetike
P 3.4	Promovimi dhe mbështetja e sistemeve te avancuara të ngrohjes në lidhje me eficiency e energjise. Masë administrative	Masë jo-strukture	Numri i sistemeve të ngrohjes me performancë të lartë energjetike
P.3.5	Zbatimi i kodeve ndërtimit për eficiency e energjise elektrike në ndërtimet private si pjesë e procedurave të lejeve të ndërtimit.	Masë/ Rregullore Udhëzim	Numri i ndërtesave të ndërtuara në sektorin rezidencial
Kosto Totale	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2025-2028		
Prioritarizimi	Në këtë kontekst prioritare shihen 2 projektet që kanë të bëjnë me rehabilitimin e ndriçimit të ambjenteve të përbashkëta apo incetivimin e ndërtimit të PV si dhe masa administrative për lehtësimin fiskal për ndërtimin e sistemeve të performancës së energjise në objektet private. Më pas masat e tjera duhet të implementohen deri në fundin e ligjshmërisë së planit.		

PS.4	Programi për eficiency e energjisë në sektorin komercial dhe të biznesit në Komunën e Junikut		
Ky program strategjik synon rehabilitimin dhe reduktimin e konsumit të energjisë elektrike në sektorin komercial dhe të biznesit duke implementuar sisteme me performancë të lartë energjitike në mënyrë që të kemi reduktimin e konsumit energjetik. Implementimi i sistemeve të PV po ashtu synon reduktimin e kostove energjetike apo reduktimin e emetimeve të GS në zonë.			
Projekti / Masa		Lloji i masës	Indikator
P 4.1	Nxjtja dhe mbështetja kombëtare për vendosjen e PV Solare në ndërtesat industriale dhe tregtare.	Projekt	Numri i impianteve PV të instaluar si rezultat i skemës kombëtare
P 4.2	Zbatimi i kodeve të ndërtimit për eficiency e energjisë në ndërtimet komerciale.	Projekt	Numri i ndërtimeve industriale apo të biznesit sipas implementimit të eurokodeve të ndërtimit
P 4.3	Krijimi i databazës së konsumit energjetik dhe mirëmbajtja e saj në bashkëpunim me institucionet e linjës	Masë administrative	Krijimi i databazës
Kosto Totale	Shih planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2025-2028		
Prioritarizimi	Në këtë kontekst prioritare shihen 2 projektet që kanë të bëjnë me nxitjen e ndërtimit të impjanteve PV dhe zbatimit të eurokodeve të ndërtimit për ndërtesat industriale. Më pas masat e tjera duhet të implementohen deri në fundin e ligjshmërisë së planit siç është krijimi i databazës për monitorimin e konsumit energjetik në ndërtesat industriale.		

PS.5		Programi për eficiency e energjisë në sektorin e transportit në Komunën e Junikut	
Ky program strategjik synon zhvillimin e sektorit të transportit dhe levizshmërisë së automjeteve të orientuar drejt transportit të qëndrueshëm dhe të pastër i cili është miqësor me mjedisin. Kjo do të arrihet nëpërmjet nxitjes së implementimit të politikave të tilla si ndërrimi i flotës së automjeteve publike me automjete me performancë të lartë energjetike duke ulur ndjeshëm emetimet në mjedis të GS. Po ashtu duke nxitur levizshmërinë jo motorrike (siç është levizja me biçikleta).			
Projekti / Masa		Lloji i masës	Indikator
P 5.1	Blerja e flotës së re të automjeteve teknologjike për pastrimin e qytetit (projekt)	Projekt	Numri i automjeteve të reja hibride të cilat përdoren për pastrimin e qytetit
P.5.2	Blerja e makinave hibride apo elektrike të cilat përdoren nga Komuna Junik.	Projekt	Numri i automjeteve publike të reja hibride apo elektrike
P 5.3	Zhvillimi i korsive të biçikletave në qendrën e qytetit të Junikut (rreth 10 km)	Masë administrative	Metër linear korsi biçikletash të ndërtuara
P 5.4	Lehtësirat fiskale dhe ulja e taksave për makinat e reja hibride dhe elektrike.	Masë jo-strukturore	Makina të blera hibride të reja ose elektrike me lehtësira fiskale
P.5.5	Ndërtimi i 3 stacioneve për karikimin e makinave elektrike.	Masë/ Rregullore Udhëzim	Numri eurokodet e ndërtimit
P 5.6	Promovimi i mënyrave të transportit të pamotorizuar.	Masë	Zhvillimi i 2 aktiviteteve të promovimit të lëvizshmërisë miqësore me mjedisin
Kosto Totale	Shih Planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2025-2028		
Prioritarizimi	Në këtë kontekst prioritare shihen blerja e automjeteve të reja për pastrimin e qytetit dhe blerja e automjeteve të reja hibride apo elektrike për institucionin e Komunës Junik. Më pas aktivitetet e tjera do të implementohen deri në fund të ligjshmërisë së planit.		

PS.6		Programi për nxitjen e parimeve të efijencës së energjisë në nivel komunal	
Ky program strategjik synon ndërgjegjësimin e popullatës dhe aktorëve të ndryshëm në territor. Benefitet që mbart për mjedisin përfshin ndër të tjera rritjen e performancës energjetikë në sektorë të ndryshëm duke reduktuar emetimin e GS në atmosphere. Ky program strategjik mbart veprime konkrete edhe në nxitjen e këtyre politikave drejt efijencës së energjisë duke synuar arritjen e targetave kombëtarë deri në vitin 2030.			
Projekti / Masa		Lloji i masës	Indikator
P 6.1	Përditësimi i studimeve të fizibilitetit për RE(solare, erë) dhe prezantim para financuesve, investitorëve, donatorëve	Masë	Numri i studimeve të fizibilitetit
P.6.2	Krijimi i një hartë diellore për të promovuar gjenerimin e burimeve të rinovueshme në komunë	Masë	Hartimi i studimit
P 6.3	Monitorimi ndërsektorial dhe i konsumit të energjisë në mbarë qytetin	Masë administrative	Metodologjia/ zbatimi i metodologjisë së monitorimit
P 6.4	Zhvillimi i seminareve ndërgjegjëse për efijencën e energjisë (2 të tillë ne vit, bazuar në popullatë dhe në biznese)	Masë jo-strukturore	Zhvillimi i dy seminareve
P 6.5	Fushatat e sensibilizimit për energjinë e rinovieshme dhe efijencën e energjisë (2 në vit)	Masë/ Rregullore Udhëzim	Zhvillimi i dy fushatave
Kosto Totale	Shih Planin e veprimit		
Kohëzgjatja	2025-2028		
Prioritarizimi	Në këtë kontekst të gjithë projektet janë njësoj prioritare duke u zhvilluar deri në fund të ligjshmërisë së planit		

10.2 PLANI I VEPRIMIT TË PROJEKTEVE

Projektet prioritare që burojnë nga programet strategjike të efijencës së energjisë, janë të përmbledhura në tabelën më poshtë. Kjo tabelë shërben për të strukturuar ndërhyrjet kryesore sipas programit përkatës, duke identifikuar projektet, nivelin e tyre të prioritetit,

institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe kontributin e tyre financiar. Kjo ndihmon në planifikimin, koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për rritjen e qëndrueshmërisë energjetike në Komunën e Junikut.

Projektet		Periudha	Institucioni kontribues	Kosto në Euro
Programi për efijencën energjetike të ndërtesave komunale				
P 1.1	Rehabilitimi i plotë i ndërtesave administrative të komunës së Junikut në kuadër të rritjes së efijencës së energjisë: a) Rinovimi i veshjeve termike duke përfshirë edhe dritaret dhe dyert b) rinovimi i mbulesave të ndërtesave, c) modernizimi i sistemeve të ngrohjes së ndërtesave. Në masën 50% (këtu përfshihen të gjithë objektet në administrim të komunës Junik) (nr i objekteve dhe sipërfaqja e tyre). Projekt.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	2 730 000
P 1.2	Ndërtimi i PV diellore në catitë e ndërtesave publike me kapacitet të instaluar për të mbuluar 40% deri në 60% të sasisë së konsumit energjetik të ndërtesave publike. Projekt.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	350 000

Projektet		Periudha	Institucioni kontribues	Kosto në Euro
P 1.3	Përditësimi i inventarit të ndërtesave publike komunale, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i konsumit të energjisë. Masë.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	10 000
P 1.4	Programi i ndërgjegjësimit për EE në shkolla. Masë.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	5 000
P 1.5	Trajnimi i kujdestarëve/menaxherëve të energjisë. Masë.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	5 000
Programi për eficiencën e ndriçimit publik				
P 2.1	Vendosja e linjave të ndriçimit publik me PV në zonat e largëta të cilat nuk kanë nevojë për furnizim elektrik. Projekt.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	160 000
P 2.2	Program i ngritjes së kapaciteteve të rinovimit të ndriçimit, dhe i teknologjive të avancuara të mirëmbajtjes. Masë.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	60 000
P 2.3	Përditësimi i inventarit të ndriçimit; monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i konsumit të energjisë. Masë.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	10 000
P 2.4	Auditimet energjetike, projektimi i detajuar inxhinierik dhe dokumentet e tenderit. Masë.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	70 000
Programi për eficiencën e energjisë në sektorin rezidencial				
P 3.1	Ndriçi efikas në hapësirat publike të ndërtesave kolektive të banimit (shkallaret dhe LED me sensor). Projekt	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	PA
P 3.2	Programi për incetivimin e PV në çatitë e objekteve private për rritjen e prodhimit të energjisë së pastër dhe reduktimin e GS. Projekt.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	PA
P 3.3	Ulja e taksës së Pronës dhe e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja me teknologji SMART për eficiencën e energjisë. Masë administrative.	2025-2028	Komuna Junik	0
P 3.4	Promovimi dhe mbështetja e sistemeve të avancuara të ngrohjes në lidhje me eficiencën e energjisë. Masë administrative.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	50 000
P 3.5	Zbatimi i kodeve të ndërtimit për eficiencën e energjisë elektrike në ndërtimet private si pjesë e procedurave të lejeve të ndërtimit.	2025-2028	Komuna Junik	0
Programi për eficiencën e energjisë në sektorin komercial dhe të biznesit.				
P 4.1	Nxitja dhe mbështetja kombëtare për vendosjen e PV Solare në ndërtesat industriale dhe tregtare.	2025-2027	Komuna Junik, Donatorë	PA
P 4.2	Zbatimi i kodeve të ndërtimit për eficiencën e energjisë në ndërtimet komerciale.	2025-2028	Komuna Junik	0
P 4.3	Krijimi i databazës së konsumit energjetik dhe mirëmbajtja e saj në bashkëpunim me institucionet e linjës.	2025-2028	Komuna Junik	0
Programi për eficiencën energjetike të lëvizshmërisë				
P 5.1	Blerja e flotës së re të automjeteve teknologjike për pastrimin e qytetit. Projekt.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	100 000
P 5.2	Blerja e makinave hibride apo elektrike të cilat përdoren nga Komuna Junik.	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	350 000
P 5.3	Zhvillimi i korsive të biçikletave në qendrën e qytetit të Junikut (rreth 10 km)	2025-2027	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	500 000

Projektet		Periudha	Institucioni kontribues	Kosto në Euro
P 5.4	Lehtësirat fiskale dhe ulja e taksave për makinat e reja hibride dhe elektrike.	2025-2027	Komuna Junik	0
P 5.5	Ndërtimi i 3 stacioneve për karikimin e makinave elektrike.	2025-2028	Komuna Junik, GIZ, BE, AKEE	60 000
P 5.6	Promovimi i mënyrave të transportit të pamotorizuar.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	5 000
Programi për nxitjen e parimeve të efijencës së energjisë në nivel lokal				
P 6.1	Përditësimi i studimeve të fizibilitetit për RE(solare, erë) dhe prezantim para financuesve, investitorëve, donatorëve.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	25 000
P 6.2	Krijimi i një hartë diellore për të promovuar gjenerimin e burimeve të rinovueshme në komunë.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	25 000
P 6.3	Monitorimi ndërsektorial dhe i konsumit të energjisë në mbarë qytetin.	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	20 000
P 6.4	Zhvillimi i seminareve ndërgjegjësuese për efijencën e energjisë (2 të tillë në vit bazuar në popullatë dhe ne biznese).	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	10 000
P 6.5	Fushatat e sensibilizimit për energjinë e rinovueshme dhe efijencën e energjisë (2 në vit).	2025-2028	Komuna Junik, Donatorë	10 000

11. FINANCIMI

IPA (Instrumenti i Para-asistencës së ParaAderimit) Kosovë-Shqipëri, Kosovë-Mal i Zi dhe Kosovë-Maqedoni e Veriut. Këto programe ndërkufitare midis Shqipërisë – Italisë dhe Malit të Zi ofrojnë mundësi të mira për komunat në të gjithë territorin e Kosovës, për të qenë pjesë e projekteve dhe partneriteteve me institucione nga vendet e tjera pjesë e programit. Pjesë e aksioneve prioritare të programit është dhe prioriteti 2, i cili synon të promovojë Agjendën e Gjellbër për Ballkanin. Në këto programe ka Objektiva Strategjike që lidhen drejtpërdrejtë me efijencën e energjisë, reduktimin e CO2 dhe Dekarbonizimin. Gjithashtu këto prioritete kanë të alokuar pjesën më të madhe të buxhetit të programit, përkatësisht çka nënkupton mundësi të mira për njësitë e qeverisjes vendore për të avancuar agjendat e tyre mbi efijencën e energjisë. Në kuadër të këtyre programeve priten të hapen thirrje për projekte, të cilat mund të ndikojnë direkt në fushat e synuara. Kjo do të thotë që komunat, të cilat janë të lejuara të aplikojnë për këto projekte, kanë mundësi të mira për të jetësuar disa nga masat e strategjive nëpërmjet këtyre thirrje. Është e

rëndësishme që të kihet parasysh norma e bashkë-financimit e cila për projekte të tilla është minimumi 15%.

Horizon Europe: Është programi më i madh i Bashkimit Evropian i cili financon kërkimin shkencor në fusha të ndryshme. Ky është një program shumë ambicioz dhe relativisht i vështirë për njësitë e qeverisjes vendore që të bëhen pjesë. Gjithsesi, një mundësi e mirë në këtë rast është bashkëpunimi i komunave me institucione akademike e kërkimore në mënyrë që të futen në partneritet për të konkurruar. Kuptohet që duke qenë një program me një fokus kryesor në kërkim shkencor dhe inovacion roli i komunave mund të jetë kryesisht në formën e pilotimit të nismave të ndryshme dhe ngritjen e kapaciteteve.

Agjenci Zhvillimi Ndërkombëtare dhe Donatorë: Agjenci të ndryshme zhvillimi ndërkombëtare operojnë në Kosovë prej vitesh si UNDP, GIZ dhe SIDA, etj. të cilat në programet e tyre synojnë edhe përmirësimin e kushteve të mjedisit, dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zvogëlimin

e riskut. Mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet ndihmës së drejtpërdrejtë, ku komunat përzgjidhen nga vetë institucionet për mbështetje ose nëpërmjet aplikimeve apo granteve konkurruese. Komunat duhet të jenë të kujdesshme për të aplikuar në projekte të tilla ose për të lobuar për t'u bërë pjesë e mbështetjes që ofrohet nga këto institucione. Gjithashtu, komunat duhet të koordinojnë me OSHC të cilat operojnë në territorin e tyre për t'i orientuar që projektet të jenë në sinergji me objektivat strategjike e zhvillimore të komunave.

Ministria e Ekonomisë në Republikën e Kosovës nëpërmjet Agjencisë së Kosovës për Energji të Rinovueshme: Në këtë kuadër në Republikën e Kosovës kemi thirrje ciklike të hapura për zhvillimin e

projekteve të ndryshme të konsumatorëve të ndryshëm për rritjen e efijencës së energjisë ku këto thirrje kanë fokuse të ndryshme. Kryesisht këto fokuse lëvizin nga rehabilitimet e sistemeve kapotë të cilat ulin koston e energjisë, vendosjen e impianteve fotovoltaike, vendosjen e impianteve për energjinë termike apo edhe të ngrohjes së ujit. Nga viti 2022 deri ne 2025 kemi rreth 10 thirrje të tilla ku më e madhja ka qenë me një shumë prej 6 milion eurosh ku pritej të përfitonin rreth 10 000 familje. Me një orientim të mirë nga komuna, një numër i konsiderueshëm i këtyre familjeve mund të ishin nga Juniku. Ky proces është një proces i vazhdueshëm dhe në vazhdim do të ketë thirrje të tjera të cilat mund të ndihmojnë në arritjen e targetit për reduktimin e CO2 dhe rritjen e efijencës së energjisë.

12. MONITORIMI I PROJEKTEVE DHE MASAVE

Monitorimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë është një komponent kyç për sigurinë e suksesit të këtij plani. Ai do të zhvillohet në dy nivele të ndryshme: monitorimi i implementimit të projekteve dhe monitorimi i impaktit të tyre në nivelin e energjisë dhe mirëqenies së komunitetit. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar që çdo masë dhe projekt të realizohen sipas qëllimeve të përcaktuara, duke mundësuar vlerësimin dhe rishikimin e aktiviteteve.

Për fillim, është e nevojshme të kuptohet se si dhe në çfarë mase po zbatohet ky plan. Për këtë arsye, për çdo projekt strategjik të përfshirë në plan, janë përcaktuar tregues të saktë për monitorimin e zbatimit të tyre. Këto tregues do të maten në bazë vjetore dhe do të mundësojnë që komuna të ndjekë në mënyrë të drejtpërdrejtë progresin e zbatimit të planit. Raportimi i këtyre të dhënave do të bëhet në dy nivele: nivelin e komunës, ku përfshihen titullarët e institucioneve dhe Këshilli Komunal, dhe në nivelin më të gjerë, ku mund të shpërndahen tek institucione të tjera të linjës, siç janë KEDS dhe Agjencia e Kosovës për Efijencën e Energjisë.

Megjithatë, vetëm monitorimi i zbatimit të planit nuk është i mjaftueshëm. Është po aq e rëndësishme të monitorohet ndikimi i zbatimit të këtij plani në efijencën e energjisë dhe në përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike të komunitetit. Për këtë qëllim, komunat duhet të përdorin tregues të përpiluara dhe të përshtatura për të vlerësuar rezultatet që po arrihen nga zbatimi i masave. Treguesit do të maten të paktën një herë në vit dhe do të raportohen në instancat përkatëse siç është parashikuar më lart. Ky monitorim i vazhdueshëm ndihmon jo vetëm për të siguruar zbatimin efektiv të planit, por edhe për të përmirësuar programet e ardhshme dhe për të përshtatur masat në përputhje me zhvillimet e reja dhe nevojat e komunitetit.

Për më tepër, ky proces monitorimi është shumë i rëndësishëm kur Komuna Junik do të duhet të rishikojë Planin Komunal të Veprimit të Energjisë dhe Klimës. Treguesit e matur në mënyrë sistematike mund të ofrojnë një panoramë të saktë të përparimit dhe të nivelit të arritjes së objektivave. Kjo siguron që procesi i rishikimit të bëhet me

informacion të plotë dhe të saktë, duke ofruar mundësinë për përshtatje të nevojshme. Këto tregues mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, elementët si:

- Sasia e kursimit të energjisë nga zbatimi i projekteve të efijencës në bazë vjetore në nivel Komunal.
- Numri i personave dhe përdoruesve që përfitojnë nga kursimi i energjisë në nivel komunal.
- Numri i ndërtesave që përfitojnë nga kursimi i energjisë në nivel komunal.
- Numri i bizneseve që përfitojnë nga reduktimi i energjisë si pasojë e zbatimit të projekteve mbi efijencën.
- Përcaktimi i përqindjes së zbatimit të projekteve të Planit për Efijencën e Energjisë në Komunën Junik dhe investimet e realizuara.
- Përqindja e zbatimit të Planit në numrin e projekteve të zbatuara.
- Numri i personave të trajnuar nga stafi i

komunës në lidhje me çështje të efijencës së energjisë.

- Numri i projekteve të financuara nga donatorët.
- Sasia e fondeve të ardhura nga donatorët.

Në këtë mënyrë, procesi i monitorimit i siguron Komunës Junik një mbikëqyrje të vazhdueshme të progresit, duke siguruar që çdo projekt të realizohet në përputhje me standardet dhe objektivat për efijencën e energjisë, ndërkohë që krijon mundësi për korrigjimin e devijimeve dhe përmirësimin e zbatimit të mëtejshëm.

Si detyrë kryesore për monitorimin e këtij Planit dhe parimeve të efijencës së energjisë në nivel vendor kjo edhe në kuadër të legjislacionit të posaçëm, do të duhet të vendosen kapacitete njerzore të punësuar në komunë ku ndër të tjera të kenë si pjesë punës së tyre edhe monitorimin e PKVEK apo dhe zbatimit të projekteve që indokjnë në rritjen e efijencës së energjisë.

6. REFERENCAT

Komuna Junik. (2025) Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2025 - 2033

Republika e Kosovës.(2025) Plani Kombëtarë për Energji dhe Klimë

Komuna Junik. (2019) Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2019-2021

Rregulloren Nr. 02/18 për Metodologjinë Kombëtare për Kalkulimin e Performancës së Integruar Energjetike të Ndërtesave

CoM: The Covenant of Mayors for Climate and Energy Reporting Guidelines, 2016

UA Nr. 05/2021 Për kornizën e përgjithshme të raportimit për Eficiencë të Energjisë

GIZ: Model i Planit Komunal të Veprimit për Energjinë dhe Klimën (MECAP) 2022 – 2030, Tetor 2021

UA Nr. 09/2017 për Zyrat Komunale të Energjisë

Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, 2016

Ligji Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, 2018

Ligji Nr. 08/L-123 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive ekzekutive, 2023

AKK: Zbatimi i Politikave të Eficiencës së Energjisë në nivel Lokal, Prishtinë, 2020



Financuar nga
Bashkimi Evropian